

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.11(377)

NENTOR 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

HISTORIA

LANÇ, epopeja më lavdishme e luftimeve të popullit shqiptar



FAQE 4

INTERVISTA



GJENERAL PIRO AHMETAJ: FAMILJA ËSHTË GJITHÇKA, AT-DHEU FILLON TE PRAGU I SHTËPISË

FAQE 6-7

LIBRI



“LANÇ NË DIBËR”, VEPËR DINJITOZE E SHKRIMTARIT DHE PUBLICISTIT SAKIP CAMI

Nga Halil Rama

FAQE 11

Zv/Ministri i Mbrojtjes Petro Koçi dhe Zv/Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, mesazhe vlerësimi dhe mbështetjeje për OBVL-në

KUVENDI I VAZHDIMËSISË SË OBVL

OBVL, histori suksesi

Nga Myfit GUXHOLLI*

Kuvendi i VI-të i OBVL, është i një rëndësie të veçantë, për vetë momentin historik në të cilin mbahet, në kuadrin e dy ngjarjeve të rëndësishme:

Më pak se një muaj na ndan nga festa jubilarë e 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut nga okupatori nazifashist.

Ndërkohë, Organizata jonë e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, më 18 korrik të këtij viti mbushi 25 vjet nga krijimi i saj. Do të donim që këto dy ngjarje historike t'i festonin bashkë me kryetarin tonë, Heroin e Popullit dhe Nderin e Kombit, gjeneral Rrahman Parllakun...por fatkeqësisht ai nuk është më fizikisht mes nesh.

Pasi e drejtoi organizatën tonë me largpamësi e devotshmëri për dy dekada, zemra e tij pushoi së rrahuri më 15 shtator, duke na lënë në pikëllim të thellë..., por edhe të vendosur për të zbatuar porositë e tij, për të mbrojtur e propaganduar vlerat e LANÇ-it.

Gjeneral Parllaku ishte dhe mbetet burim frymëzimi për brezat. Ai me përkushtim të rrallë e drejtoi organizatën tonë mbarëkombëtare dhe përkushtimi i tij bëri që OBVL të anëtarësohet në Federatën Botërore të Veteranëve.

Kontributi i tij në organizimin e drejtimin e LANÇ e të Ushtrisë Shqiptare e renditi gjeneral Parllakun në krye të plejadës së gjeneralëve shqiptarë që bënë epokë.

Ne brezi, që bëmë Luftën e Lavdishme Nacionalçlirimtare dhe ju pasardhësit tanë të denjë, krenarë që bëjmë pjesë në OBVL-në e drejtuar në këto 25 vjet nga dy personalitete të shquara kombëtare: dr. Ymer Dishnica e gjeneral Parllaku, zotohemi sot se ky do të jetë Kuvendi i vazhdimësisë së OBVL-së të drejtuar prej tyre.

(Vijon në faqen 2)



Për përjetësimin e veprës së gjeneral Parllakut, Kuvendi i VII-të i OBVL, i propozon Këshillit Bashkiak të Tiranës që emri i tij t'i vendoset një sheshi apo një rrugë kryesore në kryeqytetin shqiptar.

Po ashtu i propozon Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, që në sheshin qëndror, brenda mjediseve të këtij institucioni të vendoset busti i gjeneral Parllakut

FAQE 3

75-VJETORI I ÇLIRIMIT

OBVL dhe Bashkia Bulqizë i kanë propozuar presidentit Meta ta dekorojnë “Nderi i Kombit”



PËRKUJTOHET 76 VJETORI I RËNIES SË DËSHMORIT AHMET CAMI

FAQE 8

PËRKUJTIMORE

Në Viti u përkujtua 77-vjetori i Aradhës së parë partizane “Zenel Hajdini”



FAQE 9

REAGIMI

Dëmtimi i monumenteve të LANÇ, akt vandal kundër interesave të kombit

Nga Bashkim Hisari

FAQE 9

PROFIL

Qemal Gegollari, i ntektuali që promovoi vlera qytetare

FAQE 5

SHTËPI BAZË E LANÇ

KONTRIBUTI NË LANÇ I PARTIZANIT NGA ZALL DARDHAGANI HYSA

FAQE 3

STUDIMI

HISTORIA E TRAJTIMIT TË PRONËS NË SHQIPËRI

Nga Kol Dedaj

FAQE 10

TRADITA

ISUF XHAFFERRI, IMAZHI I ARRINORIT

FAQE 3

KUVENDI

Aktiviteti i OBVL është vlerësuar nga Presidenti i Republikës, duke na akorduar tituj nderi e dekorata për personalitete e drejtues të Organizatës

Nga Myfit GUXHOLLI*

(vijon nga fq.1)

Organizata jonë, në këtë Kuvend, po bën një ndryshim cilësor në përbërjen dhe strukturën e saj organizuese e drejtuese. Megjithëse të vonuar, po kurorëzojmë përfshirjen në organizatë të pasardhësve, të parashikuar në Statutin tone, të miratuar që në mbledhjen themeluese dhe në Kuvendin tonë të parë.

Duke bërë këtë ndryshim në strukturë e përbërje, mendojmë se gjallërojmë Organizatën, për të përmbushur në vazhdim detyrat fisnike e historike të kujtimit të atyre që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë dhe të atyre që megjithëse bënë sakrificë sublime në luftë, për fat të keq e pësuan nga regjimi diktatorial.

Të vazhdojmë me brezat e ardhshëm, të mbrojmë lavdinë e asaj lufte heroike, ta ndihmojmë historinë të thotë të vërtetën.

Këto që thashë, i kemi në platformën e Programin e Organizatës.

Me pjesëmarrjen tuaj në Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, shpresoj dhe besoj se në vazhdimësi, këto detyra do të zbatohen, pasi koha bën të veten; brezi ynë po shkon drejt shuarjes; kjo është e kuptueshme, pionieri i luftës, 13-vjeçari i atyre viteve të zjarra e të lavdishme, sot është 89 vjeç.

Ju faleminderit që ju përgjigjet ftesës tonë për të marrë pjesë në Organizatë, duke pranuar Programin dhe Statutin tonë, për të çuar më përpara trashëgiminë tonë të vyer, duke ruajtur dhe propaganduar vlerat e LANÇ; vlerat atdhetare patriotike të popullit e kombit tonë. Ky është një Mision Historik, që na nderon të gjithëve.

HISTORIA 25 – VJEÇARE E ORGANIZATËS TONË ËSHTË VËRTETË NJË HISTORI SUKSESI

Historia 25 – vjeçare e Organizatës tonë është vërtetë një histori suksesi. Një pjesë të punës e aktiviteteve të organizatës sonë i keni të dokumentara në Librin mbi historikuin e OBVL. Shumë veteranë e familje të tyre e kanë këtë libër, po kanë mbetur ende ekzemplarë që mund t'i lexoni, ndërkohë që e gjeni të botuar të plotë edhe në faqen e organizatës tonë në internet. Aty do të gjeni punën që kanë bërë paraardhësit tuaj, për të përkujtuar e përjetësuar ngjarjet historike dhe sakrificat që bëri brezi i rinisë sonë në Luftën Nacionalçlirimtare. Në këtë libër, në formën e një enciklopedie, janë figurat e shquara që drejtuan Luftën, si dhe fatkeqësia që e gjeti popullin tonë nën diktaturën e Enver Hoxhës, sidomos me goditjen që mori elita e kombit dhe ata që drejtuan e komanduan në luftën për çlirim.

Siç thashë, Organizata jonë gjatë këtyre 25 viteve është përpjekur të përkujtojë ngjarjet historike të luftës dhe të mbrojtë me konsekuencë të vërtetë e saj, duke luftuar e denoncuar publikisht shtrembërimin e fallsifikimin e historisë.

Kemi përkujtuar e propaganduar ngjarjet e datat historike, veprimet luftarake të njësive e reparteve. Këtë e kemi bërë në mënyrë të vazhdueshme, sipas një kalendari të veçantë, me kohën, vendin e repartet pjesëmarrës. Ky aktivitet gjindet i dokumentuar në shtypin e shkruar, në emisionet radiotelevizive, në librat e shkruar me kujtime nga veteranë, etj. Një vend të veçantë në veprimtarinë tonë kanë zënë mbledhjet përkujtimore, me pjesëmarrje të gjerë të figurave historike kombëtare e në veçanti të atyre që i vrau, burgosi e persekutoji diktatura. Këto veprimtari janë pasqyruar gjerësisht në mjetet e informimit publik dhe plotësisht në gazetën tonë "VETERANI".

OBVL, histori suksesi



PASQYRIM I GJERË MEDIATIK I VEPRIMTARISË SË OBVL

Organizata jonë, nëpërmjet drejtuesve e anëtarëve të saj u ka bërë një pasqyrim të gjerë mediatic, në të gjitha gazetatat e radiotelevizionet, ngjarjeve historike të luftës, kujtimit të heronjve e dëshmorëve. Veçanërisht gazeta jonë "Veterani" ka bërë një punë të madhe në këtë drejtim dhe për këtë një meritë të veçantë ka zoti Halil Rama, jo vetëm si kryeredaktor i gazetës, por dhe me lidhjet që ka krijuar me shtypin e drejtuesit e televizioneve për pasqyrimin në to të veprimtarisë sonë. Por meritë e Z.Rama është dhe krijimi i rrjetit të bashkëpunetorëve të tij të ngushtë, mes të cilëve mund të përmendim zotërinjtë: Sakip Cami, Xhemal Meçi, Shpendi Topollaj, Prof.Dr.Ana Lalaj, Kol Deda, Kadri Tarelli, Murat Gecaj, Dr.Leonidha Peppo, Zaim Sefa, etj.

Ne nuk varemi nga asnjë parti politike, por kjo nuk do të thotë se nuk kemi mbajtur qëndrim kur kemi parë se po cënohen të drejtat e bashkëkombësve tanë, kudo që jetojnë. Këtë e kemi bërë me deklarata zyrtare, në shtyp dhe emisione e debate televizive.

Gazeta jonë pasqyron ngjarjet kryesore në Kosovë dhe të shqiptarëve kudo që jetojnë. Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës i dërgojmë një kontigjent gazetash për arkivin dhe për anëtarët e kryesisë së saj.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ, lidhjet me shtetin i mban me Ministrinë e Mbrojtjes, pasi organizatat e veteranëve, invalidëve e familjeve të dëshmorëve kanë mbështetje të drejtpërdrejtë nga ky dikaster. Ne marrim pjesë në të gjitha aktivitetet që kanë lidhje me zhvillimet historike. Ministria na jep një subvencion nga buxheti i saj për të përballuar shpenzimet e botimit të gazetës "VETERANI" dhe të aktiviteteve tona. Ajo na ka mbështetur edhe me mjete transporti për lëvizjet e gjata e të shumta brenda dhe jashtë vendit. Marrëdhëniet tona janë korrekte dhe kemi patur mirëkuptimin e mbështetjen e duhur nga drejtuesit e ministrisë e të Shtabit të Përgjithshëm. Bashkëpunim të frytshëm kemi patur dhe kemi me Shoqatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës.

Organizata jonë është anëtare e Federatës Botërore të Veteranëve të Luftës prej Dhjetorit 2003. Si organizatë jemi përfaqësuar në të gjitha kongreset e kësaj Federate me të deleguarin tonë Astrit Leka që banon në Zvicër, por edhe me delegacione të organizatës. Gjithësesi e kemi patur të pamundur të plotësonim gjithë kuotën e anëtarësisë, por kemi patur mirëkuptim.

Në këtë vit jubilar të 75-vjetorit të çlirimit të atdheut nga okupatorët nazifashistë do të donim një angazhim më konkret nga qeveria për organizimin e aktiviteteve përkujtimore, por kjo nuk ndodhi. Organizatat e veteranëve nuk u përfshinë në komisionin qeveritar, siç kishte ndodhur me vitet tjerë jubilarë të kësaj lufte të lavdishme. Fondet e caktuara për mirëmbajtjen e riparimin e varreve të dëshmorëve, përmendoreve e memorialeve të Luftës, u përdorën për koncertet e rinisë në Pezë.

Por duhet të pohojmë se aktiviteti i Organizatës tonë është vlerësuar nga Presidenti i Republikës, duke na akorduar tituj nderi e dekorata për personalitete e drejtues të Organizatës.

100 VJETORI I LINDJES TË GJENERAL PARLLAKUT ORGANIZUAR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS, ILIR META RRITI DUKSHËM PRESTIGJIN ORGANIZATËS TONË

Organizimi i ceremonisë së 100 vjetorit të lindjes të gjeneral Parllakut nga Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e tij, Ilir Meta ja rriti dukshëm prestigjin organizatës tonë.

Që në themelimin e saj para 25 vitesh, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇI përcaktoi në dokumentat e saj themeluese, vazhdimësinë nëpërmjet pasardhësve të veteranëve. Në më shumë se dy dekada veprimtari intensive, krahas themeluesve, ish-veteranë të LANÇI, drejtues të spikatur të formacioneve partizane dhe më vonë të ushtrisë shqiptare, si Dr.Ymer Dishnica, Skënder Malindi, Edip Ohri, Hamit Keçi, Tahir Voshtina, Shaban Reçi, Liri Belishova, Myfit Guxholli, Sotir Budina, Jorgji Terca, Genci Ballanca, Fluturak Vinçani, Isuf Imeraj e dhjetra figura të tjera të shquara, pasardhësit e tyre kanë qenë të pranishëm. Dhe jo vetëm si figurantë, apo në sfond, por si pjesë vitale e kësaj organizate me një histori të lavdishme.

Jo vetëm përvoja shqiptare, por edhe ajo botërore eidenton domosdoshmërinë e vijueshmërisë së aktivitetit të organizatave të veteranëve të luftës. Është fakt që në veprimtaritë e ndryshme me karakter politik, patriotik e social, gjithmonë ka qenë i dukshëm kontributi i madh dhe i përhershëm i veteranëve. Por gjithsesi është e pamundur vijueshmëria e aktivitetit të OBVL, pa e trashëguar traditën tek më të rinjtë.

Para tre vitesh, në korrik 2016, në një Konferencë rajonale të organizatave të veteranëve të vendeve të rajonit të Ballkanit, që u mbajt në Zabljak të Malit të Zi,

përveç, Prof. Dr.Ljubomir Sekuliq, si organizator, spikatën edhe dhjetra të rinj, si përfaqësues të organizatave të veteranëve të Kroacisë, Sllovenisë, Serbisë e Bosnje-Hercegovinës. Midis tyre edhe Presidenti i Federatës Botërore të Veteranëve, norvegjezi Dan Vigo Bergtun, i cili ishte rreth 40 vjeç.

Ajo që ra në sy në këtë event të rëndësishëm ishte prania e shumë pasardhësve të veteranëve. Nëse norvegjezi 40-vjeçar Dan Vigo Bergtun, vinte si President i Federatës Botërore të Veteranëve, kryetarja e Org.Veteranëve të Kroacisë ishte një e përafërt me të në moshë, si bija e një gjenerali kroat me emër. Të tillë ishin edhe përfaqësuesit e Serbisë e të Sllovenisë.

I solla këto shembuj për të evidentuar rolin që kanë pasardhësit edhe për vijueshmërinë e OBVL-së. Edhe në veprimtaritë e saj kanë qenë dhe janë prezentë në vijimësi zonjat e nderuara Tatjana Parllaku, Arlinda Keçi, Mirjana Ohri, Marjana Zegali, Natasha Tahiri, Bujana Jakova, si dhe zotërinjtë Ilir Malindi, Dashamir Tahiri e disa të tjerë, vajza e djem të themeluesve e drejtuesve të OBVL-së. Por tashmë, që prindërit sa vijnë e largohen në moshë, është koha që ato të marrin përgjegjësi konkrete në organizimin dhe drejtimin e veprimtarive të kësaj organizate. Për më tepër, kur si pjesë vitale e saj janë bërë herë pas here edhe ikona të artit e kulturës sonë kombëtare, si artistet e popullit Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Rajmonda Bulku, nga pasardhësit e drejtpërdrejtë kërkohet një angazhim më i madh, që ata të trashëgojnë Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar (OBVL), historia e së cilës është me të vërtetë një histori suksesi.

OBVL njihet tashmë si organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare. Këto vlera janë përqafuar e propaganduar nga pasardhësit e denjë të veteranëve, si ish ushtaraku gazetari e shkrimtari i njohur Sakip nga historianët, studjuesit e publicistët e mirënjohur Xhemal Meçi e Nikolla Sudar, nga Ing.Kol Deda por janë dhjetra të tjerë, ish ushtarakë të devotshëm, të mirëprirur në radhët e strukturat e OBVL.

Me prurjet e reja në organizatën tonë, si pasardhës, duke na u bashkuar edhe pasardhës të denjë veteranësh, si shkrimtari i mirënjohur Lutfi Hamnku, intelektual Shuaip Methasani, veprimtari shembullor Muharrem Gjoka, Rajmonda Maleçka etj, shpreh bindjen për një të ardhme të sigurtë të OBVL.

Nëse organizata jonë nderohet e respektohet dhe i dëgjohet fjala kudo, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Prishtinë, Gjakovë e Prizren, apo edhe në veprimtari promovuese, siç ndodhi kohët e fundit në promovimet e librave të ish ushtarakëve Kujtim Boriçi e Demir Rusi, është koha që ata pa asnjë mëdyshje të bëhen pjesë e kësaj organizate. Ish ushtarakë të shquar, të pranishëm në këto promovime, si gjeneral Dilaver Laçi, Ismail Shulku, Sokol Agolli e të tjerë do të ishin trashëgimia e vyer e kësaj organizate, anëtare e Federatës Botërore të Veteranëve. Ata kanë se ç'të mësojnë nga bilanci i pasur i veprimtarive, jo vetëm produktive, por edhe cilësore të OBVL, të fokusuara në konferenca shkencore e sesione jubilarë, por dhe në botime produktive e cilësore.

***Raport i mbajtur në kuvendin e VII-të të OBVL - Tiranë, më 01.11.2019.**

**Kol.Myfit GUXHOLLI
Kryetar i OBVL**

Zv/Ministri i Mbrojtjes Petro Koçi dhe Zv/Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, mesazhe vlerësimi dhe mbështetjeje për OBVL-në

KUVENDI I VAZHDIMËSISË SË OBVL-SË

• Në Kuvendin e VII-të Kombëtar, veteranët dhe pasardhësit konfirmuan vazhdimësinë e OBVL-së së krijuar e drejtuar nga dr.Ymer Dishnica dhe gjeneral Rrahman Parllaku

Me datë 1 nëntor 2019 në Akademinë e Shkencave të RSH u mbledh Kuvendi i VII-të Kombëtar i OBVL (Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar).

Ky kuvend mbledhëj 6 javë pas ndarjes nga jeta të kryetarit të OBVL, Heroit të Popullit, Nderi i Kombit Gjeneral Rrahman Parllaku. Gjeneral Parllaku u nda fizikisht, por ai do të mbetet nderi dhe lavdia e kësaj organizate.

Kuvendi votoi unanimisht që z.Myfit Guxholli të zgjidhet kryetar i OBVL-së, i cili më pas mbajti raportin për veprimtarinë e organizatës nga Kuvendi i VI e deri më sot (botuar i plotë në faqen 2).

Përveç kryetarëve dhe sekretarëve të 12 organizatave të qarqeve të Shqipërisë në këtë kuvend merrnin pjesë të ftuar nga organizata homologe. Mernnin pjesë Zv.ministri i Mbrojtjes Z. Petro Koçi, Zv.Shefi i Shtabit të përgjithshëm të FARSH Gjën. Brig. Manushaqe Shehu. Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe kryetari i saj Zija Mulaxha dërgoi një telegram urimi. Një telegram urimi nga SHBA dërgoi edhe organizata e grave veterane "Shpresë dhe Paqe" nga Nju Jorku e kryesuar nga Mimoza Dajçi. Telegramet u lexuan nga Sekretari për organizatat homologe dhe mardhëniet me jashtë Sakip Cami.

Kuvendin e përshëndeti Zv.ministri i Mbrojtjes Petro Koçi, i cili në fjalën e tij vlerësoi punën e OBVL-së për pasqyrimin e luftës antifashiste nacional çlirimtare, rolin e kryetarit Rrahman Parllaku dhe shprehu besimin se organizata do të ecë në rrugën e nisur nga ai.

Gjithashtu edhe Zv. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjën.Brig. Manushaqe Shehu duke uruar kryetarin e ri të sapozgjedhur shprehu besimin se OBVL do të vazhdojë në rrugën e kryetarëve të saj Ymer Dishnica dhe Rrahman Parllaku. Gjeneral Parllaku ishte modeli ynë nënvizoi ajo.

Në Kuvendin e VII-të Kombëtar, veteranët dhe pasardhësit konfirmuan vazhdimësinë e OBVL-së së krijuar e drejtuar nga dr.Ymer Dishnica dhe gjeneral Rrahman Parllaku, që nga krijimi i saj para 25 vitesh. Diskutantë të shumtë në këtë Kuvend, si Prof.Dr.Shefqet Hoxha, Ali Demushi, Hyqmet Zane, Kol Deda, Azis Keta, Dashamir Tahiri etj, floën për

NË KUVENDIN E 7-TË KOMBËTAR TË OBVL U ZGJODHËN:

- **Kol.Ing.Myfit GUXHOLLI**, Kryetar i OBVL;
- **Av.Msc.Halil Rama**, Sekretar i Përgjithshëm;
- **Prof.Dr.Shefqet Hoxha**, nënkryetar i OBVL;
- **Muharrem Gjoka**, nënkryetar i OBVL;
- **Mirjana Ohri**, nënkryetare e OBVL;
- **Maksim Vinçani**, nënkryetar i OBVL;
- **Kol Deda**, Sekretar për çështjet organizative të OBVL;
- **Tatjana Parllaku**, Sekretare për marrëdhëniet e OBVL me intistucionet shtetërore;
- **Sakip Cami**, Sekretar për marrëdhëniet e OBVL me organizatat dhe shoqatat homologe brenda e jashtë vendit.



një histori sukcesi të OBVL në këto 25 vite që nga krijimi i saj dhe u angazhuan për vazhdimësinë e OBVL-së sipas Programit dhe Statutit të saj.

Kuvendi i 7-të Kombëtar i OBVL nderoi me Mirënjohje Zv.ministrin e Mbrojtjes Petro Koçi, Zv.Shefin e Shtabit

të Përgjithshëm të FA të RSH Gjën. Brig. Manushaqe Shehu si dhe drejtuesit e organizatave në rrethe: Genc Ballanca (Durrës), Fluturak Vinçani (Korçë) Ligor Haxhi (Përmet), Xhemal Meçi (Pukë) Ali Demushi (Shkodër), Natasha Tahiri e Rajmonda Maleçka (Tiranë).

Në fund, pas miratimit të ndryshimeve në Statutin e OBVL, u zgjodh Këshilli i Përgjithëm i OBVL me 45 anëtarë.

Organizata e Gruas "Shprese & Paqe" SHBA, mesazh urimi Kuvendit të VII-të të OBVL-së

Të nderuar veteranë të LANÇ e pasardhës!

Organizata e Gruas Shqiptare - Amerikane "Shprese & Paqe" në SHBA, si pjesë e hershme bashkëpunimi me Organizatës tuaj, ku vite më parë u angazhuam edhe ne për të përkujtuar Konferencën e Buajnit në Neë York, e të ftuar nga Tirana patëm një delegacion të kryesuar nga Gjeneral Rrahman Parllaku, ju dërgojmë urimet më të mira në Kuvendin tuaj të VI-të dhe i urojmë suksese te metejshme kryetarit të ri të OBVL, Kolonel Myfit Guxholli.

Ndërkohë që pritet festimi i 75 vjetorit ndaj fashizmit dhe shënimi i 25 vjetorit të themelimit të OBVL-së, shpresojmë që edhe në të ardhmen të kemi një frymë të mirë bashkëpunimi, ashtu siç kemi patur edhe kur OBVL drejtohej nga Gjeneral Rrahman Parllaku, i cili me inteligjencën, reputacionin e përkushtimin e tij të palodhur i dha një frymë të re e kumtimplote vlerave të LANÇ e të drejtave të veteranëve, anëtarë të kësaj organizate.

Ai e bëri të njohur organizatën në nivele të larta kombëtare e ndërkombëtare dhe la pas literaturë të rëndësishme, kurikulare dhe kujtime të vlefshme historike.

Gjithashtu shpresojmë se Shqipëria, Kosova dhe të gjitha trevat e saj do të vazhdojnë të kenë një bashkërendim të mirë të punës me OBVL-në, përse i përket përkujtimit të ngjarjeve të luftës, datave dhe figurave të shquara të kombit tonë, e lirisë e paqes në vend.

Si Organizatë e Gruas "Shpresë & Paqe" në SHBA, kemi ndjekur me vëmendje edhe veprimtarinë e Kolonel Myfit Guxholli dhe jemi impresionuar vërtetë me punën e tij dashamirëse, të palodhur e krijuese ndaj kësaj Organizate. Si protagonist në luftë e dëshmimtar okular i saj, në shënimet e tij, botuar në gazetën "Veterani" dhe shtypin e kohës, Kolonel Guxholli ngre tematika të luftës dhe patriotizmin e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

I urojme punime të mbara Kuvendit e suksese në drejtimin e OBVL-së Kolonel Myfit Guxholli!

Shëndet të gjithë veteranëve e anëtarëve të OBVL-së dhe mirëutakofshim në veprimtari të tjera patriotike e atdhetare!

Me respekt
Organizata e Gruas "Shprese & Paqe" SHBA

Kryetare
Mimoza Dajçi
31 Tetor 2019, SHBA

TELEGRAM

KUVENDIT TË VII-të TË OBVL TË SHQIPËRISË, TIRANË

Të dashur veteranë të Luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Të dashur pjesëmarrës në Kuvendin e VII-të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) të Shqipërisë.

Urojmë që Kuvendi i juaj të shënoj sukses dhe të jetë insiprim për gjeneratat e reja për të vazhduar frymën e vlerave të LANÇ. Urojmë që udhëheqësia e re të vazhdojë fuqishëm dhe të dëshmojë vazhdimësinë e sukseseve të organizatës tuaj, të jetësojë synimet dhe veprimet që do të japin kontribut më të madh në kultivimin dhe afirmimin e vlerave të LANÇ, në



mbrojtjen dhe të ruajtjen e traditave tona të shenjëta liridashëse dhe kombëtare.
(Vijon në faqen 8)



HISTORIA

Organizimi i Ushtrisë NCÇL, nga çetat e batalionet deri te brigadat, divizionet e koorparmata

LANÇ, epopeja më lavdishme e luftrave të popullit shqiptar

• Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është një nga epopetë e luftërave më të lavdishme që ka bërë populli ynë. Kjo luftë filloi me rezistencën ndaj pushtuesve fasistë më 7 prill 1939 dhe vijoi kundër pushtuesit gjerman dëri në çlirimin e plotë më 29 nëntor 1944

Inq. Myfit GUXHOLLI

Kemi hyrë në muajin jubilar të 75 vjetorit të çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist. Kjo festë duhet të shndërrohet në një impuls të rëndësishëm frymëzimi për të nxitur nga një histori reale të LANÇ edukimin e rinisë me patriotizimin e popullit tonë.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është një nga epopetë e luftërave më të lavdishme që ka bërë populli ynë. Kjo luftë filloi me rezistencën ndaj pushtuesve fasistë më 7 prill 1939 dhe vijoi kundër pushtuesit gjerman dëri në çlirimin e plotë më 29 nëntor 1944.

LANÇ ishte epopeja më e lavdishme dhe që i tregoi botes se si edhe një popull i vogël lufton dhe fiton kundra dy armiqve të mëdhenj. Në vitet 1939-1944, lufta që bëri populli ynë dhe ushtria jonë NÇL na bashkoi me koalicionin e Madh Antifashist: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Anglia. Ushtria NÇL lindi dhe u plotësua nga populli me njësite guerile, çeta partizane, batalione, grupe operative, brigada, divizione dhe korparmata, të shpërndara në të gjithë territorin duke arritur deri në 70 000 forca partizane.

Nga dita në ditë rritej besimi tek populli, tek UNÇL duke parë konkretisht se e vetmja shpresë ishte lufta ANÇL, prandaj rriteshin dhe forcat partizane, duke u organizuar dhe përgatitur për një sulm të përgjithshëm në të gjithë vendin.

Në tetor 1944 u formuan shumë reparte partizane duke përfshirë edhe divizione. Në të njëjtën kohë ishte çliruar 70-80% e territorit duke përjashtuar qytetet që shtriheshin gjatë rrugëve nacionale që i zotëronin trupat gjermane për lëvizjen e trupave nga Jugosllavia, Greqia e Kosova.

Në 11 tetor 1944 u çlirua qyteti i Sarandës nga forcat e dy brigadave partizane të cilat filluan sulmin nga Qafa e Gjashtës. Qyteti ishte i rrethuar nga të gjitha anët. Forcat armike të përforcuara me armët e rënda, bënë përpjekje të mëdha për të zm-



brapsur forcat partizane, por nuk ia arritën dot qëllimit. Ata u detyruan të lënë pozicionet e luftimit dhe të largohen nga kishin ardhur. Humbjet e armikut qenë të mëdha. Ata lanë 56 ushtarë të vrarë dhe një kolonel. Ju zunë 15 topa, 6 makina, 350 pushkë, 25 mitraloza dhe shumë materiale luftarake (Arkivi i degës së Historisë Ushtarake).

ÇLIRIMI I VLORËS MË 15 TETOR 1944

Pas luftimeve të suksesshme në Sarandë, partizanët e Brigadës së 12-të Sulmuese, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm nisin organizimin për çlirimin e Vlorës. Për mbrojtjen e këtij qyteti, komanda gjermane kishte marrë masa të mëdha duke përqëndruar trupa në Llogara, Tragjas, Rradhimë, Drashovicë, Mavrove, etj. Luftëra të ashpra ishin zhvilluar për të marre këto fshatra dhe do të krijohesh një brez ushtarak që të çlirohej Vlora. Humbjet nga forcat armike qenë të mëdha, me të vrare e të plagosur. Mercenarët ishin futur në panik të madh. Forcat armike ishin përqëndruar kryesisht në Topull sepse po të merrej ky vend, humbej një pikë strategjike e rëndësishme. Hapej një rrugë që mundësonte çlirimin e Vlorës dhe të një zone më të madhe. Njëkohësisht forcat armike u mbyllën në Vlorë. Në 15 tetor, komanda partizane vendosi të çlirojë Vlorën. Me gjithë përpjekjet e dëshpëruara, gjermanet nuk i rezistuan dot sulmeve të rrepta partizane dhe u larguan në drejtim të Fierit duke djegur dhe urën e Mifolit. Humbjet e gjermaneve në njerëz e materiale ishin të mëdha.

ÇLIRIMI I QYTETIT TË KUÇOVËS

Pas çlirimit të Beratit forcat partizane u udhëzuan që të kishin shumë kujdes që pasuritë, si vendburimet e naftës të ruheshin të mos digjeshin e të ktheheshin në gërmadha. Komanda fashiste gjermane kishte marrë masa të mëdha duke sjellë edhe forca plotësuese si tanke, artileri të rëndë, etj., mbasi ky qytet ishte një objekt i rëndësishëm për forcat gjermane. Shtabet e brigadave të 8-të dhe 16-të

sulmuese, duke marre një informacion të saktë mbi armikun e studiuan dhe më së fundi vetëm me një sulm të rrufeshëm bënë që të ruheshin e të mos zhdukeshin pusët e naftës, distileria, centrali elektrik dhe të çlirohej qyteti pa u dëmtuar.

Forcat partizane ishin në gatishmëri të plotë dhe pa u gdhire mirë, nëpër vendin e minuar kaluan në sulm të rrufeshëm dhe nëpër një tym të dendur çliruar qytetin. Forcat naziste u larguan me humbje duke lënë disa të vrare e të plagosur. Megjithatë, ata bënë shumë dëme. Kështu me 17 tetor 1944 Kuçova u çlirua.

FORMIMI I BRIGADËS SË 24-TË SULMUESE

Shtabi i Përgjithshëm duke parë situatën në të gjithë vendin dhe që sulmet vazhdonin me sukses nga të gjithë repartet partizane, duke konsideruar që mbështetja e popullit për luftën kundra forcave gjermane rritej dhe nga ana taktike operative nevojiteshin forca rezerve për të arritur në çlirimin e gjithë vendit dhe sidomos të kryeqytetit tonë të dashur, Tiranës, dha urdhër për formimin e forcave të tjera. Njëkohësisht, në disa zona, nga operacionet që bënë gjermanet së bashku me kolaboracionistët, ishin dëmtuar dhe kështu kërkohej rregullimi i plotë i tyre. Me 4 tetor 1944 u krijua në Bicaj të Lumes, Brigada e 24-të Sulmuese.

Në këtë krahinë qysh në vitin 1943 qenë formuar edhe çeta partizane. Shumë bij të kësaj krahine mbushën vullnetarisht radhët e çetës por mbi të gjitha krijuan dhe Brigadën e 24-të Sulmuese. Zona e veprimt të saj ishte të godiste forcat gjermane, Kukës-Prizren. Kjo në bashkëpunim me Brigadën e 18-të Sulmuese. Me vonë Brigada e 24-të Sulmuese u caktua të vinte në afërsi të Tiranës. Forcat e Brigadës së 24-të i mbanin në presion forcat gjermane duke i goditur here pas here në afërsi të Tiranës. Kjo brigadë dha një ndihmë të çmuar në çlirimin e kryeqytetit. Me vone ajo u inkadrua në Divizionin e 2-të Sulmues.

Ne vazhdim të urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm për një çlirim të plotë të ter-

ritorit afrohen dhe forca të tjera në afërsi të Tiranës, që ishin forca me eksperience luftimi siç ishte Brigada e 1-rë Sulmuese, Brigada e 4-ët Sulmuese, Brigada e 5-të Sulmuese, etj.

BRIGADA E 9-TË SULMUESE, 28 TETOR 1944

Shtabi i Përgjithshëm krijoi reparte të tjera dhe brigada e deri divizion për të pasur rezerva gjatë luftimeve luftarake përfundimtare në të gjithë vendin. Ushtria jonë Nacional Çlirimtare duke zbatuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm në 28 tetor të vitit 1944 themeloi Brigadën e 9-të Sulmuese, duke bashkuar të gjitha batalionet territoriale që vepronin në qarqun e Korçës si "F. Bubani", "Reshit-Collaku", "Skënder Çaçi", "Tomori" dhe "Hakmarrije". Inaugurimi u bë në fshatin Lozhan. Brigada me një efektiv prej 1500 partizanësh u plotësua me kuadro me eksperience të mirë të fituar në luftime nga këto batalione, si dhe armë dhe municion. Zona e veprimeve luftarake të kësaj brigade ishin Kolonja, Korça, Bilisht. Me 29 tetor kjo brigadë mori sektorin e luftimeve dhe menjëherë goditi kolonën gjermane në Qafën e Qarrit. Kjo brigadë gjatë luftimeve që zhvilloi në rrethin e Bilishtit, Ersekës dhe Pogradecit, i shkaktoi forcave armike gjermane dëme të mëdha. Kjo brigadë zhvillonte luftime deri në postbolloqet e qyteteve të ushtrisë armike. Në 22 tetor batalioni i 1-rë i kësaj brigade u rreshtua pranë shtabit operativ të Korçës që të çlironte këtë qytet, ndërkohë që batalionet e tjera vazhdonin veprimet luftarake në zonat e lartpërmendura. Nga goditjet e njëpasnjëshme të partizanëve të kësaj brigade gjermanet u larguan dhe me tërheqjen e trupave mori fund historia e kësaj brigade të LANÇL të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare.

Divizioni i 3-të Sulmues

Me 10 tetor 1944 me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm u formua Divizioni i 3-të Sulmues i përbërë nga Brigada e 12-të, e 14-të dhe e 19-të me reparte që kishin një eksperience luftarake të zhvilluar nga luftimet e shumta me forcat gjermane në rajonet e tyre.

Në urdhrin e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm thuhej: "Për të njësuar veprimet e Brigadave tona dhe për të bërë më të fuqishme goditjen kundër okupatorit gjerman dhe kolaboracionistëve të tyre, urdhërojmë formimin e Divizionit të 3-të Sulmues i cili do të mbledhë në gjirin e vetë Brigadën e 12-të, 13-të dhe 19-të Sulmuese".

Njëkohësisht, Shtabi i Përgjithshëm u dërgon përsëritetje të gjithë reparteve të Divizionit të 3-të Sulmues. Ndër të tjera thuhej: "Kemi bindjen se ky Divizion me përbërjen e tij me kuadro dhe partizanë të cilët kane një eksperience të madhe në

(Vijon në faqen 5)



PROFIL


Tre vite pa Qemal Gegollarin, intelektualin që promovoi vlera qytetarie

Nga Halil Rama

I afirmuar si pjesë e elitës së Ushtrisë Shqiptare, por edhe si publicist, poet e prozator, që zë vend nderi në historinë e letrave shqipe, Qemal Gegollari ka hyrë me dinjitet në analet e kësaj historie. Ai kultivoi dhe promovoi vlera qytetarie, që në etapa dhe forma të ndryshme, në ecjen e njerëzve me kohën e për kohën, nëpërmjet kontributit të tyre modest dhe historik, kanë komunikuar dhe vazhdojnë të komunikojnë, mesazhe modeste e komplekse, dialogimin e së kaluarës, qartësinë e së tashmes dhe udhën e së ardhmes, ndjenja të shpallura këto, për të kuptuar vazhdimësinë e jetës, krenarisë dhe përjetësisë, vlera që sigurojnë identitetin e qytetarisë dhe dhe inteligjencës.

Qemal Gegollari ishte biri i një familjeje me tradita e emër të mirë, nga Gjergjenica e krahinës së Oparit, ku gjenden të kombinuara, mençuria, bujaria, fisnikëria e zemërgjerësia, që ai do t'i mëshironte e perfeksiononte ato gjatë gjithë karrierës së tej prej afro pesë dekadash.

Në distancë e kam njohur para më shumë se katër dekada, kur ai drejtonte një nga njësitë më të rëndësishme ushtarake, brigadën e Artilerisë në Ish-Korpusin e Burrelit. Bashkëkohësit e vlerësonin komandantin për ato tipare të thjeshtësisë e të komunikimit me drejtues e ushtarë të thjeshtë, por edhe me qytetarë të Burrelit me të cilët qante hallet e tyre të punës e të jetës.



Rezultatet e suksesshme në punë, shumë shpejt sollën edhe vlerësime, për guximin e rrallë, qëndrimin heroik në frontet më të vështira dhe për marrëdhëniet e tij korrekte në shoqëri e familje.

Autori i dhjetëra rregulloreve për modernizimin e ushtrisë, drejtuesi i talentuar, miku më i shtrenjtë i oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve e qytetarëve, nderohej gjithnjë prej tyre.

Kësisoj, ky intelektual shumëdimensional do të kishte një karrierë gjithnjë në ngjitje, të admirueshme për kolegët e bashkëpunëtorët e tij të shumtë.

Ai kishte marrëdhënie shumë të afër-

ta me ta, ndaj edhe e vlerësonin si një ndër ushtarakët elitarë që do të jepte një kontribut të rëndësishëm në modernizimin e konsolidimin e ushtrisë shqiptare, si dhe në veprimtarinë e OBVL-së e OUPLSH-së.

Dijet dhe njohuritë e tij kulturore, Qemal Gegollari i shpalosi edhe në veprimtarinë letrare e publicistike. Si zë i njohur në fushën e letrave, fillimet e tij marrin udhë në gazetën "Luftëtari" ku botonte herë pas here shkrime me tematikë të veprimtarisë së Ushtrisë Shqiptare.

Ndërkohë emri i Qemalit zë vend edhe në organe të tjera të shtypit si në gazetën "Bashkimi", "Zëri i Popullit", "Ushtria Popullore" etj. Jeta në pension i favorizoi me shumë kohë për krijimtari. Njeri kurajoz, i cili me vullnetin e tij bëri të akumulojë më shumë kulturë në botën e letrave për t'u bërë i njohur edhe në gjini e lloje të tjera letrare si në "kronika historike" monografi të figurave të shquara, poezi dhe prozë.

Kjo punë e palodhur dhe humluese bëri që 14 botime veprash të mbajnë autorësinë e tij, të cilat tashmë ndodhen të arkivuara në Bibliotekën Kombëtare, pa lënë mënjane botimin periodik të gazetës "Opari" pasqyrë e ngjarjeve dhe historisë së vendlindjes. E gjithë kjo veprimtari ka treguar se sa e ka dashur Qemali vendlindjen e tij, se sa i lidhur ka qenë me popullin e asaj krahine dhe se sa me dashuri e vërtetësi ka evidentuar luftërat për liri e pavarësi kombëtare të oparikëve. Kontributi i tij e kalon gjeografinë e



krahinës, sepse është kontribut edhe për historinë kombëtare.

Si njeri tepër dinamik, në lëvizje dhe kërkim të pasosur njohurish dhe vlerash, ai ishte shumë i lidhur me funksionet shumë të përgjegjshme, të cilat i kreu me devotshmëri, kompetencë e profesionalizëm të lartë deri në majat e Ushtrisë Shqiptare.

Gjithë ky aktivitet i dendur e mjaft produktiv i një personaliteti shumëdimensional si Qemal Gegollari na bën të hulumtojmë më shumë rreth jetës dhe produktit që ai la pas në të mirë të shoqërisë dhe të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit.

Të lësh pas një emër të mirë është vlerë njerëzore për shoqërinë dhe krenari për familjen, të afërmit e miqtë. Dhe Qemal Gegollari e la emrin e mirë.

LANÇ, epopeja më lavdishme e luftimeve të popullit shqiptar

(Vijon nga faqja 4)

luftë kundër armikut, do të plotësojë detyrën dhe të ngrejë lart flamurin e ushtrisë sonë heroike dhe duke i dhënë grushte vdekjeprurëse pushtuesit të urryer gjerman." Ky divizion duke zhvilluar luftime të suksesshme kundër pushtuesve dhe zbatuar të gjitha detyrat e ngarkuara, së bashku me repartet e tjera të Ushtrisë Nacional Çlirimtare do të shpejtonte çlirimin e popullit dhe atdheut tonë të dashur.

KORPARMATË E I-RË SULMUESE, 20 GUSHT 1944

Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, me 20 gusht 1944 u formua njësi me e madhe e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, Korparmatë e I-rë Sulmuese. Deri në vjeshtë të vitit 1944 në përbërje të Korparmatës përfshiheshin Brigada e 1-rë, e 6-të, e 7-të, e 15-të, e 17-të, e 22-të, 23-të, e 24-ët dhe e 28-të të cilat i takonin Divizioneve të 1-rë, 2-të dhe të 4-ët. Të gjithë këto forca kryenin veprimet luftarake të tyre në të gjithë zonat e Shqipërisë se Mesme e të Veriut e kryesishit në qarqet e Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Peshkopisë, Kukësit dhe Shkodrës. Duke zbatuar me vendosmëri urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm, partizanët e partizanet, komandantët e komisarët heroikë të Korparmatës se 1-rë Sulmuese luftuan me trimëri dhe me përkushtim duke ndihmuar fuqimisht në

çlirimin e vendit.

20 DITË LUFTIME TË SHPRA PËR ÇLIRIMIN E KRYEQYTETIT

Më 17 nëntor mbushen 75 vjet nga çlirimi i Tiranës, datë që përbën një nga ngjarjet më kulmore në Historinë e LANÇ. Në Luftën për çlirimin e Tiranës morën pjesë 8 brigada të inkuadruara në Korparmatën e Parë të UNÇ të drejtuar nga Dali Ndreu, Hysni Kapo, Mehmet Shehu e Qazim Kondi. Në këtë betejë të lavdishme u dalluan veçanërisht partizanët e brigadave të I-rë, IV-t, VIII-të, X-të e XVII-të. Sulmi partizan për marrjen e Tiranës, filloi me 29 tetor 1944 e konsistoi në përqendrimin e brigadave të mësipërme në territoret e përcaktuara nga Shtabi i Përgjithshëm. Brigadat partizane synonin marrjen e objektivave konkrete brenda Tiranës, si Ministrinë, Pallatin e Brigadave, etj., dhe mbështetjen e aksioneve të kombinuara, deri në fitore.

Me gjithë sulmet e shumta e të shpeshta të gjermanëve (2-3 në ditë), Brigada e 4-t, në harkun e 13 ditëve arriti të kryejë e përballojë rreth 60 sulme e goditje, shumicën me fitore. Nga këto veprime ushtarake, në situatë lufte të ashpër pati humbje të mëdha në njerëz. Vetëm në një betejë p.sh, Brigada e 4-t, humbi 31 partizanë, ndërsa lufta e Tiranës mori jetën e 127 partizaneve e partizanëve, nga të cilët, 98 të Brigadës së 4-t. Kjo brigadë mbajti pe-

shë të konsiderueshme në këtë mësimje partizane, së bashku brigadën e parë e të tjera, duke luftuar në sektorin më të vështirë e më të fortifikuar gjerman, në Tiranë e rreth saj. Ndërkohë, edhe Brigada e Parë me luftë të përgjakshme arriti të marrë lindjen e Tiranës, zonën e spitallit, pazarin e ri deri tek Xhamia e Vjetër, ku qëndresa e gjermanëve qe shumë e fortë. Luftimet zhvilloheshin të ashpra me tërheqje e avancim të vazhdueshëm. Brigada e 4-t, që synonte Tiranën e Re, ish-blllokun gjithashtu, hyri e u tërhoq disa herë në këtë zonë ku gjermanët kishin qendra të fuqishme zjarri. Marrja e Tiranës, si objektivi më madhor i momentit të luftës partizane, solli si pjesëtare brigadat e tetë, dhjetë e shtatëmbëdhjetë. Pjesë e planit strategjik për marrjen e Tiranës, ishin ruajtja e mbrojtja e rrugëve kryesore Tiranë-Durrës, e Tiranë-Elbasan, detyrë kjo, ngarkuar brigadave të dytëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë e njëzet e katërt. Ndërkohë, brigadat e tjera vazhdonin luftimet pa reshtur duke avancuar në rrugica, rrugë, shtëpi e lagje. Gjermanët kuptuan rëndësinë e sulmit partizan dhe vendosen futjen e brigadave midis dy zjarreve, duke sjellë forca shtesë, si automatonat e nisura nga Greqia e Jugosllavia, nëpërmjet rrugës së Elbasanit. Forcat partizane u ripozonuan e përballuan dy njësitë e sapo mbërritura gjermane, njëra prej 200 forcash në Mushqeta, (Krrabë),

e tjetra prej 300 forcash, në Peqin. Luftimet me trupat e përforcuara gjermane u zhvilluan të rrepta dhe në sajë të armatimeve të forta e të rënda të formacioneve të gjermanëve, rreth 300 prej tyre, ushtarë e oficerë, çanë brezat partizane e hynë në Tiranë. Humbjet ishin të shumta dhe në radhët e partizanëve që me vetëmohim mbronin çdo pëllëmbë të Tiranës. Dhe pse hynë në Tiranë mes kufomash, tankesh e makinash të shkatërruara, gjermanët e ndjenë që rrethimi sa vinte ngushtohej e që e vetmja rrugë e tyre për tërheqje qe rruga e Kavajës. Lufta e Krrabës, përgjysmoi forcat gjermane e mbylli një shteg lëvizjeje për ta. Luftimet brenda Tiranës bënë që gjermanët, së fundi me 16 nëntor, të tërhiqnin dhe forcat e fundit të mbetura në Tiranë e të vazhdonin nga Vora drejt Shkodrës. Në mëngjesin e 17 nëntorit, Tirana u çlirua nga forcat partizane dhe vërshimi triumfator i forcave partizane, mbushi rrugët. Populli i Tiranës që luftoi krah partizanëve e që ndihmoi me çdo mjet këtë mësimje, shoqëroi luftëtarët në rrugë duke festuar e shprehur gëzimin e fitores me brohoritje, këngë e përqaftime.

Pas çlirimit të Tiranës ishte e afërt dita e çlirimit të plotë të Shqipërisë. Ushtria NCÇI i dha goditje përfundimtare forcave armike, duke shënuar fitorën përfundimtare dhe duke e rrnditur Shqipërinë me fitimtarët e Luftës së Dytë Botërore.

***Kryetar i OBVL**

INTERVISTA

36 vjet në uniformë ushtarake, 25 vjet kontribute të spikatura drejt pas Gjeneral Piro Ahmetaj: Familja është



Përmes gazetës prestigjioze "Panorama" mësuam se në datën 16 Shtator 2019, Presidenti Meta, ka nënshkruar dekretin e daljes në rezervë si dhe bashkë me të edhe përfundimin e karrierës ushtarake, 36 vjet nën uniformë të Gjeneral Brigade Piro Tasim Ahmetaj.

Si një nga mbështetësit më aktiv të OVBVL-së, gazeta jonë e kishte obligim t'i kushtonte atij këto faqe speciale, nëpërmjet intervistës si vijon:

Gjeneral Ahmetaj, si e përjetuat daljen në rezervë si dhe bashkë me të edhe përfundimin e karrierës ushtarake?

Nostalgjia brenda një mase të caktuar është tërësisht njerëzore. Sigurisht, edhe për shkak të edukimit dhe ekperiencës perëndimore, refuzoj me përbuzje përjetimin "si dramë", si dhe mëshiroj paranojën e "përjetësisë, qoftë në gradë ushtar-



ake, karriket zyrtare ose në funksionet shtetërore!

Përkundrazi, këtë ngjarje e gjej shumë të mirëpritur, bile pak të vonuar në të gjitha aspektet. Si e tillë, shpresoj shumë të shërbejë për "të shëruar dhe çliruar" nga përcaktimet e nenit 14 (absurd) të ligjit të karrierës, mbi kohën maksimale të qëndrimit në gradën aktive, i cili bie ndesh me parimin e vitalitetit të FA (sa më lartë ngjitesh aq më shpejt del nga sistemi/in or out). Uroj gjithashtu që ky rast të kontribuojë për t'u hapur rrugë gjeneratës së re, për të tejkaluar frymën e konfliktualitetit ndërstitucional, në rikthimin e besimit të pesha dhe vlerat e meritokracisë, solidaritetit dhe kohezionit në trupën e ushtarakëve si dhe zinxhirin e drejtimit të FA.

Ç'përbëjnë për Ju 36 vjet karrierë ushtarake në funksione e përgjegjësi të ndryshme?

36 vjet karrierë ushtarake, 15 përgjegjësi të ndryshme (nga komandant toge, deri Përfaqësues Ushtarak Kombëtar në NATO; Zëvendësues i Shtabit të Përgjithshëm, Këshilltar i Presidentit të Republikës), 13 mijë ditë/netë angazhime, sakrificë, privilegj, arritje, dështime, zhgënjime, keqkuptime, etj, është mision i pamundur ti përshkruash të gjitha, apo jo? Gjithsesi, në vijim do të veçoj 3 periudhat, disa nga përgjegjësitë dhe ngjarjet madhore që kanë lënë gjurmë të spikaturar në "udhëtimin tim si ushtarak" si dhe në arritjet familjare:

Së pari, për të përmbledhur pjesën e parë, 8 vjet (1983-1991) po tregoj një his-

tori personale që e kam ndarë me kolegët e huaj: "kur ndiqnim shkollën ushtarake (që siç e dini mbante emrin e diktatorit), mësimi i gjuhëve të huaja nuk ishte "me ligj" e ndaluar (ose privilegj besimi), por ata që mësonin gjuhë të huaja (përfshi së bashku mikun tim të shrenjtë (në 36 vjet), Halil Hyseni), shiheshin si subjekt dyshimi, në mos objekt për të dënuarit potencialë të radhës. Besoj ta kujtojmë të



gjithë, që mallrat kineze kishin vërshuar në treg "made in China" ose e shqipëruar "prodhim kinez". Mesazhi kësaj historie: singlerisht e konsideroj veten "made in NATO", për shkak të fatit nga përmbysja e regjimit, si dhe privilegjit që kam patur për tu investuar dhe kontribuar për 28 vjet në procesin e transformimit të sistemit të sigurisë kombëtare dhe atë të integritetit në NATO.

Së dyti, thellësisht i privilegjuar dhe maksimalish i motivuar, që për 10 vjet (nga marrja e statusit aspirant në Washington DC, (MAP/1999), deri në marrjen e ftesës në Bukuresht (2008), kam qenë pjesë e një skuadre teknikienësh elitare që u zhvilluam, u shkolluam, u rritëm profesionalisht, që kontribuam me gjithçka sa mundem, dhe i'a dolëm për të transformuar sistemin e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare: "mentalitetin, konceptin/qasjen, strukturat, infrastruktuarat, rregullat e angzhimit, modelin dhe kulturën planifikimit, bashkëpunimit me partnerët, etj", në udhëtimin drejt përmbushjes së aspiratës së anëtarësimit në aleancën më të fuqishme të historisë së njerëzimit, por edhe familjes së vlerave demokratike të globit (NATO).

Përpos të tjerave, kjo periudhë ishte një shkollë e madhe për të transformuar vetëveten, përgjatë së cilës kam pasur përgjegjësinë për ndjekur, përfaqësuar dhe prezantuar në shumë se 100 kurse e trajnime afatshkurtra në institucione dhe institute të sigurisë, si: Bruksel, Uashington, Neë York, Londër, Berlin, Romë, Paris, Otava, Varshavë, Oslo, Bukuresht, Gjenevë, Kolegji i NATO-s, Qendra Marshall, Kopenahgen, Beograd, Moskë, etj, dhe në të gjitha 29 kryeqytetet e vendeve të NATO-s. Sot i kaloj me mirënjohje të thellë në retrospektivë, nuk më besohet, dhe besoj kam të drejtë: "as në ëndrrat më të bukura, nuk e kam imagjinuar se do kisha vizituar kaq shumë vende".

Së treti, pa asnjë mëdyshje, graviteti i suksesit në karrierën time, mbetet emërimi si Përfaqësues Ushtarak Kombëtar (NMR), në Komandën Supreme të Aleancës (SHAPE/NATO). Ndihej përjetë "borxhli", shumë i vlerësuar dhe thellësisht mirënjohës, që në mars 2018, m'u ngarkua themelimi i Përfaqësuesit, si dhe mu besua drejtimi i një ekipi/bashkëpunëtorësh të përgjegjshëm që i dhamë frymën dhe shpirtin për të

KUVENDIT TË VII-të TË OBVL TË SHQIPËRISË, TIRANË

(Vijon nga faqja 3)

Sivjet, kur festojmë 75 vjetorin e fitores ndaj fashizmit, kur po shënoni edhe 25 vjetorin e krijimit të organizatës suaj dhe kur po mbani Kuvendin e 7-të kombëtar, ne kujtojmë me respektin më të madh brezin që bënë LANÇ, sakrificat e çdo veterani në të dy anët e kufirit dhe kujtojmë me krenarinë më të lartë gjithë dëshmorët e lirisë, heronjtë e LANÇ-it.

Organizata e veteranëve të LANÇ e Kosovës vlerëson lartë kontributin dhe sakrificën e jashtëzakonshme të Heroit të Popullit, Nderit të Kombit, gjeneralit të ndjerë Rrahman Parllaku, i cili me shumë sukses, për dy dekada, me përkushtim drejtoi organizatën tuaj dhe arriti të vendosë bashkëpunim të shkëlqyer mes Organizatave të Veteranëve të Shqipërisë dhe Kosovës. Fuqimisht do ta mbrojmë dhe do të mbështesim meritat e tij për LANÇ. Nuk do të heqim dorë nga idetë e

tij për liri, barazi dhe në vazhdimësi do jemi mirënjohës për gjithçka që ka bërë për kombin tonë. Shprehim bindjen se udhëheqësia re e OBVL-së, me kryetarin, kolonelin Myfit Goxholli, do të vazhdojnë me devotshmëri e përkushtim të drejtë organizatën. Veteranët e Kosovës dhe pasëardhësit e tyre, edhe me këtë rast shprehin dëshirën dhe gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin tonë të frytshëm. Bashkarisht do të jemi më të fortë dhe më me sukses do të mbrojmë vlerat e LANÇ, lirinë; do të ruajmë dhe mbrojmë interesat tona kombëtare, si në Kosovë, Shqipëri, ashtu edhe në çdo vend tjetër ku rrezikohen të drejtat e popullit tone. Lirinë e fituar me gjak nuk do t'ia japim kurrë dhe askujt.

ORGANIZATA E VETERANËVE TË LANÇ TË KOSOVËS
Zija Mulhaxha, kryetar - Prishtinë,
më 01.11.2019

përmbushur detyrimet e anëtarësimit në NATO (prill 2009), si dhe më posaçërisht në negociimin, përmbushjen e standardeve dhe nënshkrimin e 10-ra marrëveshjeve teknike të anëtarësimit të plotë (shtator 2013).

Nuk mund të lë pa përmendur disa nga arritjet madhore si në këtë periudhë, ku kemi pasur përgjegjësinë të japim kontribute më shumë se modeste: "rritja e kontributeve në operacione ndërkombëtare (në rreth 500 vetë njëherësh në vitin 2012); më shumë se 300 ushtarakë (nënoficerë, kapiten, major, nënkolonel, kolonel) në shtabet e operacioneve jashtë vendit (CE), dhe më shumë se 60 ushtarakë në strukturat e kohës së paqes (PE); u finalizua një "projekt shembullor" për demontimin e të gjithë trashëgimisë së municioneve të regjimit komunist. Buxheti i mbrojtjes arriti në 2 % e GDP-së, rreth 30% e tij u alokua për projektet madhore të modernizimit, si: vëzhgimi i hapësirës detare; anijet e patrullimit; helikopterët e gjeneratës së fundit; Forcat Speciale; kursi i lartë për sigurinë; trajnimi; dixhitalizimi i të dhënave të personelit; Muzeu i FA, një projekt dinjitoz për imazhin; u nënsh-

INTERVISTA

anëtarësimit të Shqipërisë në NATO

gjithçka, Atdheu fillon te pragu i shtëpisë



kruan disa 10-ra marrëveshje mirëkuptimi dhe teknike (MOU & TA) për: Forcat Speciale, Inteligjencën, Portokollin e Parisit/SOFA, shkëmbimi i informacionit të klasifikuar, etj., për të cilat Shqipëria meritoi përcaktimi zyrtar: “një ndër 5 vendet model për reformat e mbrojtjes dhe përmbushjen e angazhimeve ushtarake”. Kjo arritje, për mua dhe të gjithë bashkëpunëtorët do të mbeten arsye afatgjata për t’u ndjerë krenarë para vetes, familjes, shoqërisë dhe të parën nga rëndësia, para Atdheut tonë të përbashkët. Përtej modestisë së tepëruar, nuk mund të lë pa përmendur sot, tre momentet më kolmore, përjatë ushtrimit të funksionit të Përfaqësuesit Kombëtar në NATO. Jam ndjerë i përlur nga privilegji dhe përplotur nga emocionet, në ceremoninë kur (1) dorëzova flamurin kombëtar Autoriteteve të NATO-s, për tu ngritur dhe valëvitur krahas 28 vendeve të tjera. Po atë ditë, dt. 2 Prill 2009, i shoqëruar nga Komandanti (SACEUR), (2) jam ulur zyrtarisht (si i bararabart/me votë), në karrigen/tavolinën e 28 përfaqësuesve në Komandën Supreme të NATO-s.

Po ashtu, në pothuaj 6 vjet kam patur privilegjin dhe sfidën të punojë për/me 3 Komandant të NATO-s, me 3 gjeneralë amerikanë me 4 vjet, 4 vjet nga të cilat me admiral Stavridis (dekoruar nga Presidenti Nishani, me “Medaljen e Mirënjohjes”), i cili në (3) një letër-rekomandimi për dhënien e gradës gjeneral, më preku kur i’u shkruante autoriteteve: “Përfaqësuesi Juaj i parë Kombëtar, Kolonel Piro Ahmetaj, e ka ngritur shumë lartë stekën e Shqipërisë, në Komandën Supreme të NATO-s”.

Së katërti, për rreth 6 vjet në funksionin e Këshilltarit Ushtarak të Presidentit, nga “pesha e nderimit dhe barra e përgjegjësisë”, kam qenë edhe më i përlur edhe më i motivuar se në të gjitha funksionet që kam ushtruar brenda dhe jashtë vendit në këto 15 vitet e fundit, për të prodhuar produkte dhe këshilla strategjike sa më cilësore për Presidentin e Republikës, më posaçërisht për të mbështetur Kreun e Shtetit në ushtrimin e përgjegjesive kushtetuese të Komandantit të Përgjithshëm të FA dhe Kryetarit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Megjithatë, më duhet ta theksoj se “lamtumirë uniforme”, ka lidhje me daljen në rezervë, me përmbylljen e karrierës ushtarake 36 vjeçare në FA,

dhe nuk ka asnjë lidhje me funksionin e Këshilltarit Ushtarak.

Po ashtu, më duhet ta them se, nga përgjegjësia zyrtare “kapërceva kufizimet e uniformës”, për të kontribuar në modernizimin e sistemit sigursisë dhe dekriminalizimin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare; përmirësuar kontrollin dhe harmonizuar balancat kushtetuese, për të mos lejuar politizimin; për të mbjellë frymën e konsultimeve dhe konsensusit sa më të gjerë; për të mos lejuar (sh)përdorimin propagandistik të kapaciteteve të FA; gradimet/çgradimet politike; korrupsion me Planin e Përhapjes, objektet, infrastrukturën dhe burimet e mbrojtjes së FA; ulja, deformimi dhe shpërdorimi e buxhetit të mbrojtjes, etj.

Nuk po them se në 36 vjet kam qenë i pagabueshëm, por ju siguroj se si nxënësi i Colin Poëll, kam mësuar shumë si nga arritjet ashtu dhe nga gabimet. Në këto 36 vjet kam qenë “normalisht” i shoqëruar edhe nga zhgënjimet, mosmirënjohjet, xhelozirat, cinikët, sekserët, thashethemet, me të cilat “kam bërë paqe me veten”, pasi jam udhëhequr nga parimi i einston Churchill: “nëse të kafshon një qen, dhe ti kthehesh të ndukësh qenin, ke humbur destinacionin”!

E fundit, por jo nga rëndësia, me rastin e kësaj ngjarje dëshiroj ti shpreh konsideratën dhe mirënjohjen me emër për emër, eprorëve, kolegëve, bashkëpunëtorëve, miqëve të panurmurt brenda dhe jashtë vendit, që më kanë shoqëruar në këtë udhëtim të sukseshëm 36 vjeçar.

E vetmja keqardhje që ndjej sot (s’bëj askënd fajtor), është që kemi “dështuar me sukses”, që të krijojmë një traditë-respekti, sjellje dhe kulturë perëndimore, për largimin e ushtarakëve, si dhe për çdo profesion tjetër, që kontribuon një jetë në shërbim të familjes, Atdheut dhe shoqërisë. Pa mëdyshje, familja është gjithçka, Atdheu fillon te pragu i shtëpisë. E kam përmendur disa herë, që vetëm për shkak të karrierës time jashtë shtetit, është bere e mundur edukimi 10 vjeçar i dy fëmijëve në shkollat perëndimore (Romë, Bruksel, Hagë, Londër, Harvard), arritja dhe përgjegjshmëria e të cilëve më bën shumë krenar. Nga ana tjetër, ky fakt, do të vijojë të mbetet për mua dhe fëmijët “burim i pashtershëm i mirënjohjes

Kush është Gjeneral Piro AHMETAJ, 6 vjet Këshilltar Ushtarak/Mrojtjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Gjeneral Ahmetaj ka shërbyer për 36 vjet në shërbimin aktiv të FA, nga të cilat 22 vjet ekspert dhe funksione të larta në strukturat e MM; NATO dhe këshilltar ushtarak (mbrojtjes) i Presidentit të RSH.

Ka përfunduar 3 vjet Universitetin Ushtarak (1986); 2 vjet Akademinë e Mbrojtjes së Shtabit të Përgjithshëm (2002-2004), Tiranë, si dhe Kolegjin e Lartë të NATO-s, Romë (2006).

1986-1992: në detyra komandant toge deri komandat batalioni, në reparalet e FA, Shkodër, si dhe 1993-1998, zëvendës shefi i rajonit të policisë ushtarake Vlorë;

1999 – Mars 2008: Specialist, Shefi i Sektorit, Zëvendës & Drejtor në strukturat e Integritimit dhe Planifikimit Strategjik të MM, dhe me kontribute të spikatura në procesin e negociatave teknike 15 vjet gjatë dhe 10 vjet pas Anëtarësimit në NATO;

Mars 2008 - Shtator 2013, Përfaqësues Ushtarak Kombëtar në Komandën Supreme të NATO, kur/ku me autorizim të autoriteteve shtetërore ka nënshtruar disa 10-ra Marrëveshje Mirëkuptimi dhe Teknike (MoU&TA) me strukturat dhe vendet e NATO-s;

Përparimi në gradë: Kapiten në 1992; Major 1998; Nënkolonel në 2004; Kolonel në 2008. Me dekret të Presidentit Nr. 8232, datë 24.06.2013, është promovuar Gjeneral Brigade në funksionin e Përfaqësuesit Ushtarak (PUK/NMR) me rekomandim edhe nga Komandanti Suprem i NATO-s, Admiral Stavridis si dhe Ambasadorit të RSH në NATO HQ, Belgjik.

Me dekret të Presidentit Nr. 8237, datë 28.06.2013, është emëruar Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA. Me dekret të Presidentit, Nr. 8459, datë 17.01.2014, lirohet nga funksioni Zv/SHSHPPFA, dhe me vendim nr. 300, prej Janar 2014 - Tetor 2019 ka ushtruar funksionin e Këshilltarit Ushtarak (Mbrojtjes) të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Për shkak të një akuze, që de-legjitimonte ushtrimin funksioni & të gradës së lartë ushtarake si dhe integritetin e përzgjedhjes së Institucionit të Presidentit, me “kërkesë të kushtëzuar ka dalë për-

kohësisht në rezervë. Pasi është ri-konfirmuar (të administruar në Institucionin e Presidentit), pastërtia e figurës nga kjo akuzë, në shkurt 2016, Presidenti ka rikthyer në detyrë. Më tej mbas 2 vendimeve të formës së prerë të gjykatës se Apelit, (konfirmuar më edhe në Gjykatën e Lartë) dhe vlerësimeve të Presidentit, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të FA, me dekret të posaçëm, nr. 10586, dt. 17.07.2017 është rikthyer në gradën aktive Gjeneral Brigade”.

Me dekret të Presidentit nr. 11274, dt. 16.09.2019, ka dalë në rezervë nga shërbimi aktiv në FA, si dhe prej 1 Tetori 2019, është liruar edhe nga funksioni i Këshilltarit Ushtarak të Presidentit.

Kontribuues teknik në përgatitjen dhe prezantimin e dokumenteve të anëtarësimit në NATO (MAP/PARP); SSK (2004; 2014); SU (2007); PAZH 2008-2020, si dhe ekspert-rekomandues i një platforme për reformimin e Sistemit të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (mbarë) Kombëtare. Ka kryer Studimet “Master në fushën e sigurisë kombëtare”, si dhe është duke ndjekur programin e doktoratës: “Mbi nivelin e ambicies së RSH në kuadër të sigurisë kombëtare, të NATO-s dhe ndërkom-bëtare”.

Pjesëmarrje dhe prezantime në më shumë se 50 kurse afatshkurtra/mesme në vende, institucione dhe institute të sigurisë, si: Bruksel, ëashington, Neë York, Londër, Berlin, Kolegjin e NATO-s, Romë, Paris, Qendra Marshall, Otava, Oslo, Pragë, Varshavë, Gjenevë, Ankara, Beograd, Moskë, etj.

Pjesëmarrës, kontribute dhe profil të mirënjohur në komunitetin e sigurisë strategjike, pasi përveç funksioneve të përmendura ka botuar mbi 100 vlerësime në shtypin e shkruar brenda dhe jashtë vendit për sigurinë Kombëtare, Rajonale, NATO-n, UN, BE, etj.

Për përkushtim dhe kontribute të spikatura, gjatë karrierës 36 vjeçare në FA, veçanërisht në procesin e integritetit euroatlantik është vlerësuar me Urdhër, Dekorata dhe Medalje, nga autoritetet e larta shtetërore dhe ato të NATO-s.

Është i martuar, me Znj. Lindita, kanë dy fëmijë të rritur: djali Arlind si dhe vajza, Esmeralda.

dhe detyrimin ndaj vendit”. Ndiem përlësisht i detyruar, që në këtë udhëtimin 36 vjeçar (jo të lehtë), bashkëshortja, Lindita më ka shoqëruar me urtësi, modesti, dinjitet si dhe përkujdesje shëmbullore.

Ç’farë do bësh në të ardhmen, gjeneral?

Fillimisht do përmbyll disa angazhime, disa projekte vlerësimi me Kolegjin e NATO-s, Qendrën Marshall; NDU, Qendrën e Çikagos për Sigurinë Globale, USA, etj. Për më tej, garantoj se i çliuar nga “pranget e uniformës” mbetem edhe më i motivuar të kontribuoj me eksperi-

encë, ekspertizë, përlësi dhe përgjegjshmëri shtesë, për modernizimin e sistemit të sigurisë kombëtare. Ajo që mundet të nënëvizoj nga sot është Shqipëria ka nevojë kritike të ndër-marrë një debat gjithëpërfshirës, për të konsideruar dhe udhëhequr një projekt mbarëkombëtar (dhe më gjerë) me strategji, marrevëshje, projekte dhe kapacitete të përbashkëta në dobi të sigurisë së qytetareve, stabilitetit të demokracisë funksionale, dhe promovimit të interesave kombëtare.

Përgatiti:
Halil RAMA

PERKUJTIMORE

OBVL dhe Bashkia Bulqizë i kanë propozuar presidentit Meta ta dekorojnë “Nderi i Kombit”

PËRKUJTOHET 76 VJETORI I RËNIES SË DËSHMORIT AHMET CAMI

Me datën 18 tetor 2019, ora 12.00, në sheshin e shkollës 9 vjeçare “Ahmet Cami” në Gjoricë të Sipërme u zhvillua ceremonia e 76 vjetorit të rënies së dëshmorit Ahmet Cami.

Në këtë ceremoni përkujtimore organizuar në kuadrin e 75 vjetorit të çlirimit të atdheut morën pjesë veteranë dhe pasardhësit e veteranëve të LANÇ, nxënësit dhe mësuesit e shkollës “Ahmet Cami” Gjoricë dhe Shkollës “Fasli Cami” Viçisht, familjarë dhe të afërm të dëshmorit Ahmet Cami, drejtues të pushtetit vendor, qytetarë dhe banorë të Gjoricës, Shupenzës, Bulqizës, Peshkopisë, Dibrës së Madhe etj.

Morën pjesë gjithashtu kryetari i Bashkisë së Bulqizës Lefter Alla, Zv Prefekti i Qarkut të Dibrës Avni Muli, Administratori i Njesisë Administrative të Gjoricës Ilir Rama etj. Më hollësisht mbi jetën dhe veprimtarinë e dëshmorit Ahmet Cami foli e bija e dëshmorit, Tefta Cami.

Në emër të Bashkisë së Bulqizës dhe të pushtetit vendor foli kryetari i Bashkisë së Bulqizës Lefter Alla, i cili ndër të tjera tha se është i lumtur që ndodhet në këtë ceremoni përkujtimore për të shprehur konsideratat për këtë figurë të shquar të LANÇ të zonës, për komandantin e çetës së Gollobordës, Ahmet Camin.

Në fund Shkolla 9 vjeçare Gjoricë në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Bulqizës dhanë një koncert artistik me këngë e valle patriotike, ku me interes u ndoq kënga kushtuar dëshmorit Ahmet Cami me tekst e muzikë të Xhevdet Dacit dhe e interpretuar nga Hajri Alimani.

Naslije Muli



Kulla Hakik Hysës në Qa të Zall Dardhës, Bazë e Luftës

Antifashiste Nacional Çlirimtare

Kontributi në LANÇ i partizanit nga Zall Dardha Gani Hysa



Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare ka heronjtë e vetë, por të tillë ishin dhe ata që besuan tek ajo, që bashkëpunuan me partizanët me çdo lloj forme, morën armët për liri dolën malit për çlirimin e Shqipërisë. Njëri prej tyre është Hakik Musa Hysa, lindur në fshatin Qa të ish komunës Zallë Dardhë, Dibër. Ai ishte një personitet, burrë fisnik, shquhej për bujarinë në krahinën e tij dhe më gjerë dhe do t'i bashkëngjitej LANÇ në vitin 1944. Partizanët u pritën dhe qëndruan në kullën e tij për tre netë fal bujarisë, zemrës së madhe dhe të qenit patriot. Aty gjetën mbështetje duke nisur nga të ushqyerit, veshmbashje, mjekimin e plagëve etj. Kati i tretë i kullës u kthye në spital ku mjekoheshin të plagosurit e luftës. Kjo kullë ndodhet mbi kodër me muret të rrethuara si kala, prane kalasë së Zhugrit. Për këtë kullë e dentistit në brigadën e 4-të sulmuese.

një përroi. Bashkëudhëtar i im është nga Lashkiza. Ai me tregoi me gisht një shtëpi: – “Or ti shoq se nuk ta di as emrin, një ajo shtëpi është e Hakik Hysës, tash ai ka vdek. Njëherë ishte një dimër e një borë e madhe. 60 partizanë kanë kaluar këndej e kanë dashtë me u takue me Këshillin e fshatit. Atëherë ka dal në prag Hakik Hysa dhe iu ka thënë: “Ç’ka ju duhet bre burra Këshilli! Ejani brenda se është tuj iu marr frymën bora. ...Ne jemi 35 vet në shtëpi dhe kena boll opinga”. E kështu Hakiku mori nga të shtëpisë, por dhe prej të afërmeve dhe iu pajisi të gjithë partizanët me opinga...”

Ky kontakt i Hakik Hysës me partizanët bëri që ai të besonte në çlirimin e Shqipërisë dhe të nxitonte të ishte pjesë e LANÇ duke angazhuar veten dhe familjarët; djemtë Ganiun me bashkeshorten Sulbien, Shabani, Isufi, Mersimi Aqifi Musai; rejat Mihane Sulbie Fatime Dija e Safija. Hakiu falë moshës së thyer, do të angazhonte direkt në luftë djalin, Gani Hysën në brigadën e 4-të sulmuese që u themelua në Voskopojë të Korçës, ku ishte pjesë e luftimeve në jug të vendit. Gani Hysa mori pjesë dhe në çlirimin e Tiranës në betejat e përgjakshme të 14-15 nëntorit ku njëri nga bashkëfshatarët dhe bashkëluftëtarët e tij Maliq Topuzi “Dëshmor i Atdheut”, ka dhënë jetë në krahët e tij. Madje dhe Ganiu është plagosur në këtë betejë. Gani Hysa kryente dhe rolin e dentistit në brigadën e 4-të sulmuese.

Pas çlirimit të Shqipërisë, Gani Hakik Hysa do të angazhohej në krijimin e institucioneve të para demokratike pas luftës. Ai do të zgjidhej kryetar i Këshillit të fshatit ku kishte miratimin dhe respektin e bashkëfshatarëve të tij. Gani Hysa bëri çmos që jo vetëm fëmijët e tij të arsimoheshin ku sot të gjithë kanë kryer studimet universitare, por ai sa ka mundur ka ndihmuar dhe bashkëfshatarët e tij që të ndiqnin po të njëjtën rrugë. Ganiu besonte se vetëm dija do të sillte ndërtimin e Shqipërisë. Gani Hysa për merita të vecanta për Çlirimin e Tiranës pas lufte është dekoruar me “Medaljen e Çlirimit”, dhe “Medaljen e Trimërisë”.

Nga Komisioni Qendror i Statutit të Veteranit më 24.04.1996, e firmosur nga Kryetari i Komisionit Alfred Mositi, Gani Hysës i është njohur Statusi i Veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.

Isuf Xhaferri, imazhi i Arrnorit...

Nga Zaim SEFA

Në plejadën e burrave të shquar të Fisit Sefa në Arren të Kukësit, përveç emërdriturve: Sali Tahir e Halë Sene, Ibrahim Sene e Musë Hasan, Sadik Meta e Misimajt, bën pjesë edhe Isuf Sefa i Xhaferri Isufajt.


Burri me shajak e qeleshe të bardhë, armë pati fjalën e urtë e të mençur, avokate kishte gojën, prokuror mendjen. Një personifikim që rrallëkush do ta kishte, jo vetëm në Arrën, por edhe në krahinat për rreth Lurë, Dardhë e Reç. Ky burrë i shquar ndër trashëgimtarët e Misimajve kishte paraqitje fizike të admirueshme. Ishte shumë fisnik. Kishte dhe një tipar të rrallë, alegorinë dhe humorin e këndshëm mes miqsh e shokësh.

I lindur dhe rritur në një truall patriotësh, ai do të shquhej si zot shtëpie i shtëpisë së madhe dhe si përfaqësues i grupfisit në nahije. Kishte autoritetin që të përfaqësonte të mocmin dhe të sotmin.

Pikërisht këtë burrë të rrallë fati e vuri në provë, për të qenë baba i dy kurorëve, që të rriste dhe dy jetimë, nga gruaja e parë që i vdiq.

Isuf Xhaferri (lindur më 1908 dhe vdekur më 1993) që përballues i sfidave të mëdha. Burri i mençur e i kërkuar si i tillë nëpër zona, optimist për jetën, po me këtë mençuri e besnikëri do të lidhte miqësi me Adem Ahmetin në Kraj Reç, duke u kurorëzuar me të bijën e tij, Siben. Nga martesë e dytë, e bërë sipas zakonit sofra e tij u shtua dhe u bë 12, me gjithë mikun. Një shtëpi bese e bujarie, e sofrës dhe e kuvendit ku mbizotëronin autoriteti, krenaria e shumë virtyre që i trashëgonte Arrnori. Kjo familje njihet dhe për kontributin që ka dhënë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Por me gjithë këtë kontribut, njëri nga djemtë e saj, vëllai i Isufit, Baftar Xhaferri Sefa, në vitet e mëvonshme do të vihej në shënjestër si një nga të “padsiplinuarit” e fshatit. U organizua atëhere mbledhja e Organizatës së Frontit ku asistonte edhe Kryetari i Degës së Punëve të Brendshme Çapajev Taçe (me gjithë grupin e ekzekutimit). Por kur Baftari, insistonte t'i qëndronte versionit të tij, do të ishte zgjuarsia dhe mendjemprehtësia e të vëllait, Isufit, që do ta shpëtonte nga gjuetia e shtrigave. “Veni gishtin kokës Baftar se nuk ka folë.....”, por ka folë.....”, i tha Isufi që qëndronte nga fundi, tek shkallët e ish PTT ku po zhvillohej “gijqi” popullorçe. Pjesëmarrësit u befasuan nga kjo ndërhyrje...Filloi e qeshura dhe çështja mori karakter zbutës e disiplonor brenda për brenda fshatit...

Sa e sa raste të tilla ka në këtë zonë kur është dëgjuar fjala e mençur, e urtë por dhe nga karakteri burrëror i Isuf Xhaferrit. Ai ishte dhe mbetet imazhi i Arrnorit. Ndaj dhe me drejtë i këndohet kënga: “Isuf Xhaferri burrë megjelisi, s’të harrojnë krahina e fisi”.



PERKUJTIMORE

Në Viti u përkujtua 77-vjetori i Aradhës së parë partizane “Zenel Hajdini”

Bashkim HISARI

77 vjetori i themelimit të aradhës së parë partizane shqiptare antifashiste nacionaqlirimtare “Zenel Hajdini” në fshatin Ramjan të Vitisë u festua madhërisht. Me këtë rast, në shtëpinë e kulturës “Gursel e Bajram Sulejmani” në Viti u organizua një Akademi solemne. Ndërkaq, në fshatin Ramjan pranë përmendorës së “Zenel Hajdinit” dhe pllakës përkatëse u përkujtun 48 dëshmorë nga komuna e Vitisë që në Luftën e Dytë Botëre flijuan jetën për liri.

Në këtë ceremoni ku ndodheshin veteranë, pasardhës, familjarë të dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionaqlirimtare nga komuna e Vitisë dhe fshati Ramjan, nderuan me pjesëmarrjen e tyre antarët e Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionaqlirimtare (OVLANÇ) të Kosovës, kryetari Zija Mulhaxha dhe Lekë Hoxhën, djali i heroit të popullit Fadil Hoxha, pastaj përfaqësuesit e degëve të kësaj organizate nga, Prishtina, Gjakova dhe Prizreni, përfaqësuesit e pushtetit lokal, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), pjesëtarët e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që shërbejnë në kuadër të KFOR-it në Kosovë, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe antarët e SHKA “Ana e Moravës”, të cilët shfaqën një program të pasur kulturo-artistike, duke i dhënë një atmosferë festive 77 vjeorit të themelimit të aradhës partizane “Zenel Hajdini”.

Pasi u intonuan himni i Republikës së Shqipërisë dhe i Kosovës, për rëndësinë e Luftës Antifashiste Nacionaqlirimtare dhe rolin e aradhës së parë partizane shqiptare “Zenel Hajdini”, folën kryetari i degës së organizatës së veteranëve të Luftës Antifashiste



iste Nacionaqlirimtare në Viti, Ismail Sokoli, nënkryetari i Kuvendit të komunës së Vitisë, Hasan Aliu, historiani Feriz Ahmeti dhe kryetari i OVLANÇ të Kosovës Zija Mulhaxha.

Aradha e parë Partizane shqiptare në Kosovë “Zenel Hajdini” u themelua më 27. shtator të vitit 1942 në fshatin Ramjan të komunës së Vitisë. Ajo u krijua pas formimit të grupeve të para ilegale të rezistencës së armatosur të cilët u organizuan si front i përbashkët i masave popullore të proklamuar si

Luftë Antifashiste Nacionaqlirimtare për Kosovë dhe Dukagjin. Në fillim të vitit 1943, Aradha “Zenel Hajdini” u nda në dy pjesë, në aradhën “Zenel Hajdini” dhe “Emin Duraku”. Këto dy aradha nën udhëheqjen e komandantit të tyre Fadil Hoxha përhapën frymën e re antifashiste nacionaqlirimtare si e drejtë për çlirimin nga okupatori dhe me të drejtë për vetëvendosje e bashkim kombëtar. Pastaj u formua edhe aradha “Sharri” dhe shumë aradha e brigada partizane.

Dëmtimi i monumenteve të LANÇ, akt vandal kundër interesave të kombit

Nga Bashkim Hisari

Ditë më parë, në Eshtnorën Përkujtimore të dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionaqlirimtare (LANÇ) në Çabrat të Gjakovës, që me vendimin e Asambles Komunale të këtij qyteti mban emrin e heroit të popullit Fadil Hoxha, persona të panjohur dëmtuan pjesën ku ruhen eshtrat e dëshmorëve. Kryesia e Organizatës së veteranëve të LANÇ të Kosovës, shprehu shqetësimin dhe dënoi fuqimisht këtë akt vandal dhe barbar të dëmtimit të këtij monumenti të dëshmorëve të LANÇ.

Sivjet kur po festojmë përvjetorin e 75-të të fitores nga fashizmi dhe kur populli i Kosovës bashkë me tërë botën përparimtare vlersojnë lartë Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionaqlirimtare, dëmtimi dhe demolimi i monumentit të dëshmorëve në Çabrat është shembull shumë i trishtë dhe degradues për qytetarët e Gjakovës dhe Kosovës. Janë të fuqishme faktet të panumërtat për vlerat e partizanëve kosovarë

në LANÇ sa ua verbojnë sytë të gjithë atyre që mundohen të fshijnë nga historia kontributin dhe meritat madhështore të mbi 53.000 luftëtarëve dhe rreth 6.200 dëshmorëve kosovarë, të cilët në luftën më të përgjakshme në historinë e njerëzimit flijuan jetën për të siguruar të drejtën për vetëvetvendosje, liri dhe barazi.

Veprimet të tilla vandale janë apsolutisht absurde dhe shprehje e mentalitetit të nënshtruar të varfërisë shpirtërore e morale të individëve që mundohen pa sukses të errësojnë dhe të fshijnë nga historia kontributin, sakrificën dhe meritat madhështore të veteranëve dhe dëshmorëve të LANÇ-s. Ata që kanë kokën dhe mendjen e gabuar, vepruan ashtu siç kanë vepruar edhe forcat kriminale serbe gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe harruan se shteti që kemi sot ka kushtuar shumë shtrenjtë.

Çfarë shembulli i keq! Duke injoruar qenjen morale të njeriut dhe menduar se mund të bëjnë çfarë t'i vijë në mendje, të veprojnë kundër interesave të mbarë pop-

ullit dhe të kombit, këta njerëz të mbytur nga padituria dhe të ndarë nga e vërteta, tregojnë se çfarë kanë në zemër. Padyshim, si Lubia e pangopur dëshmojnë se i janë dorëzuar trathitës dhe dhunës për të shtrembëruar realitetin historik.

Fatëkeqësisht, hapësira mediatike e Kosovës ishte indiferente dhe mbeti e shurdhër për këtë ngjarje të shëmtuar që tek shumica e kosovarëve shkatoi zemërim të madh dhe u trajtua si sjellje e keqe, fyerje dhe padrejtësi. Andaj, është detyrë e organeve përgjegjëse të Republikës së Kosovës dhe komunës së Gjakovës të marrin masa urgjente dhe konkrete që të identifikojnë, denojnë dhe të pengojnë të gjitha veprimet e dhunëshme të individëve që dëshirojnë të ringjallin fashizmin, të ndjellin frikë dhe dëmtojnë proceset demokratike në Kosovë. Përndryshe, sjellje të tilla të njerzëve të fshehur do të bëhen model dhe llap i veprimeve të dëmshme ndaj vlerave të simboleve të LANÇ-s dhe proceseve demokratike që janë të apravura dhe të dëshirueshme për shumicën e popullatës shqiptare.

Zenel Hajdini, emrin e të cilit mban aradha e parë partizani shqiptare, lindi në vitin 1910 në fshatin Tupallë të Medvegjës. Mësimet e para vijoi në shkollën e quajtur “Xhamija e Sjarinës” dhe vazhdoi në Medresen e Shkupit. Një kohë punoi si ofiqar në Medvegjë. Studjoi shkencat matematiko-natyrore në Universitetin e Beogradit. Gjatë vijimit të vitit të dytë të studimeve kur plasën demonstratat e njohura të marsit, Zeneli morri pjesë aktive. Menjëherë pas shpërthimit të luftës Zeneli këthehet në vendlindje për të vazhduar aktivitetin si antar i shtabit për rajonin e Medvegjës. Është vrar nga forcat bullgaro-çetnike më 07.mars të vitit 1942.

Duke folur në këtë tubim, kryetari i degës së organizatës së veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionaqlirimtare në Viti, Ismail Sokoli ndër të tjera tha: “Luftëtarët e aradhës partizane “Zeinel Hajdini” nën komandandën e heroit të popullit Fadil Hoxha kryen disa aksione kundër fashistëve dhe çetnikëve në xehoren e Llojanit, në grykën e Carelevës dhe në Livog.

Jetën e tyre për liri, vetëvendosje dhe për një të ardhmëje më të lumtur flijuan 48 dëshmorë nga komuna e Vitisë : Abdullah Jakupi, Abdullah Maliqi, Afis Shasivari, Ahmet Bejta, Beqir Sahiti, Danush Emërllahu, Emin Sejdiu, Fetah Abazi, Hajdar Neziri, Hajrush Hyseni, Halil Kamberi, Isak Shabani, Jetish Hasani, Jetish Sinani, Mejdi Arapi, Mejdi Ahmeti, Musli Jakupi, Mustafa Shema, Nebih Luta, Nezir Demelezi, Nikollë Zefi, Qazim Muharremi, Rashit Frangu, Rexhep Haziri, Rexhep Jakup, Sadik Abazi, Sadri Zejnullahu, Sahit Zejnullahu, Sali Musliu, Sali Piraj, Saqip Alidema, Selim Rexhepi, Shaban Berati, Shasivar Abazi, Shefki Jashari, Sylë Azemi, Tahir Zeqiri, Vehbi Sali, Ymer Ymeri dhe Zejnullah Mustafa. Organizata e jonë në fshatin Ramjan për ta ka ngritur një pllakë përkujtimore që kujtojmë dhe kurrë mos të harrojmë gjakun e tyre dhënë për lirin e Kosovës”.

Nënkryetari i Kuvendit të komunës së Vitisë Hasan Aliu, pasi përgëzoi OVLANÇ të Kosovës për veprimtaritë në kuadrin e 75 – vjetorit të çlirimit nga fashizmi foli për kontributin e aradhës partizane “Zenel Hajdini” në Luftën Antifashiste Nacionaqlirimtare.

Historijani Feriz Ahmeti, tha se populli shqiptar u përgjegj apelit të koalicionit antifashist Anglo- Amerikan dhe të botës që të bashkohen të gjithë popujt e robëruar në luftën kundër fashizmit dhe të shfrytëzojnë të drejtën për vetëvendosje.

Ndërkaq, kryetari i OVLANÇ të Kosovës Zija Mulhaxha ndër të tjera tha: “Sakrificat që bëri populli shqiptarë në luftën heroike kundër fashisto-nazistëve vlersohet lartë. Në këtë luftë kontribut të çmuar dhanë luftëtarët e Aradhës partizane “Zenel Hajdini” të cilët qysh në fillim u bashkangjitën në frontin e madh Antifashist Nacionaqlirimtar dhe dolën fitimtar, pasi luftuan heroikisht kundër fashizmit.

Ata sot meritojnë të nderohen me respekt të veçantë. Pa luftën Antifashiste Nacionaqlirimtare, UÇK dhe ndihmën e faktorit ndërkombëtar me në krye NATO-ne dhe SHBA, Kosova sot nuk do të ekzistonte si shtet i pavarur”, tha kryetari i OVLANÇ të Kosovës”.

Ceremonia festive u përmbyll me një program kulturo - arstistike në vendin ku u themelua Aradha partizane shqiptare “Zenel Hajdini”, përgatitur nga nxënësit e shkollës fillore të fshatit Ramjan.

STUDIMI



Kol DEDA

HISTORIA E TRAJTIMIT TË PRONËS NË SHQIPËRI



Tiranë 2019

Ndjenja e pronës lindi dhe evolui me lindjen e zhvillimin e shoqërisë njerëzore, kështu trajtimi dhe tregtimi i pronës i ka fillesat që në lashtësi, në epokën e neolitit. Bashkësitë primitive, për të siguruar nevojat e tyre, hynë në marrëdhënie këmbimi duke i dhënë kështu jetë zanafillës së tregtisë, e cila në etapa të ndryshme të historisë ka marrë forma dhe status të ndryshëm, ku tipari themelor i kësaj periudhe është trajtimi i pronës sipas të drejtës zakonore, kemi parasysh edhe statutet e qyteteve Drisht në Shkodër, etj., duke ardhur në vitin 1876, ku për herë të parë e gjejmë të sanksionuar në Kushtetutën e Perandorisë Turke, pjesë e së cilës ishte edhe vendi ynë me të katër vilajetet e saj: Kosovë, Shkodër, Manastir e Janinë, ku të gjithë qytetarët e Perandorisë Osmane ishin të lirë në krijimin privatisht të çdo lloj aktiviteti shoqëror, tregtar, zejtarie etj, të parashikuar në këtë dokument. Për të vazhduar më tej, në kohën e Monarkisë Shqiptare, në Kodin Civil të vitit 1929, ku sanksionon format e pronës, që mund të jenë shtetërore ose private, si dhe të drejtën e përdorimit të pronës nga zotëruesi i saj pa asnjë kufizim, përveç përjashtimeve të përcaktuara në ligj. Në këtë periudhë u bë sanksionimi i disa koncepteve bazë, në mes të cilëve edhe ai i shitjes, me të cilin kuptohej transferimi i zotërimit të një pronës nga shitësi tek blerësi, i cili paguante çmimin e saj. Çmimi i shitjes përcaktohej prej palëve, megjithatë caktimi i çmimit të shitjes mund të bëhej nga një palë e tretë që sote e quajmë Vlerësues të Pasurisë, një nocion themelor ky (vlerësuesi) në trajtimin e pronës. Madje, nëse pala e tretë nuk dëshironte ose nuk mund të caktonte çmimin, atëherë nuk bëhej shitja. Në këtë periudhë një nocion tjetër i rëndësishëm në trajtimin e pronës ishte edhe ai i qerasë, ku me qiradhënie kuptohej një kontratë me të cilën zotëruesi i sendit ose i pronës i jepte palës tjetër të drejtën e gëzimit të një sendi të paluajtshëm ose të luajtshëm për një kohë të caktuar, kundrejt një çmimi të caktuar, ku përdoruesi i sendit ose pronës detyrohej t'ia paguante zotëruesit të këtyre. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945 dhe me instalimin e Pushtetit Popullor Socialist në Shqipëri, vendin e pronës private dhe të ekonomisë shumëformëshe e zuri gradualisht prona shoqërore dhe sistemi i vetëm ekonomik ishte ai i ekonomisë socialiste shtetërore.

Në këtë periudhë, në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u zhduk dhe u ndalua prona private. Pro-

na socialiste shtetërore përbëhej nga dy format e saj: prona shtetërore dhe prona kooperativiste (kjo e fundit, si formë e pronës kolektive në fshat). Në kushtetutën e kësaj periudhe është e sanksionuar që të jenë pronë ekskluzivisht vetëm të shtetit: toka, pasuritë e nëntokës, minierat, pyjet, kullotat, uzinat, fabrikat, stacionet e makinerive dhe traktorëve, bankat, rrugët, hekurudhat, portet, aeroportet, postë-telekomunikacioni (PTT), stacionet radio televizive, burimet natyrore të energjisë, si edhe çdo pasuri tjetër që krijohet nga sektori shtetëror ose që shteti fitonte në mbështetje të ligjit. Në këtë periudhë, toka u jepej në përdorim ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, si dhe shtetasve për përdorim vetjak. Toka jepej në përdorim pa shpërblim, toka mund të përdorej për qëllime të tjera vetëm me pëlqimin e organeve shtetërore. Prona e kooperativave bujqësore përbëhej nga: ndërtesat, makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, veglat dhe mjetet e punës, kafshët e punës dhe të prodhimit, kulturat drufrutore, produktet bujqësore e blegtorale si edhe mjetet e tjera të nevojshme për veprimtarinë e saj. Prona vetjake e shtetasve përbëhej nga shtëpia e banimit dhe sende të tjera që shërbenin për plotësimin e nevojave materiale e kulturore vetjake e familjare, si edhe të ardhurat nga puna dhe burime të tjera të ligjshme. Një element shumë i rëndësishëm i tregut të pronave është çmimi i tyre, që, në këtë periudhë caktohej nga shteti, i cili kishte ngritur Komitetin e Çmimeve dhe Standardeve i cili ishte në varësi të drejtpërdrejtë të Këshillit të Ministrave, me objekt ndjekjen, ndihmën, kontrollin dhe zbatimin e drejtë të vendimeve përkatëse në fushën e çmimeve e të standardeve. Një veçanti e kësaj periudhe në trajtimin e pronave ishte edhe ai i shpronësimit, ku pasuria e paluajtshme, pronë e personave të veçantë mund të shpronësohej për interes të përgjithshëm në dobi të shtetit, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, individëve, etj,

ku masa e shpërblimit nga shpronësimi caktohej nga komisionet e ngritur pranë Komiteteve Ekzekutive të rretheve ku gjendej prona. Në asnjë rast vlere e shpronësimit të pronës nuk duhej të kalonte vlerën reale të saj në kohën e shpronësimit. Pra, në këtë periudhë hasim për herë të parë edhe konceptin e vlerës reale të pronës, që natyrisht nuk është e njëjtë me vlerën e tregut të lirë të pronës, sipas standardeve evropiane të vlerësimit. Një tipar tjetër i rëndësishëm i trajtimin të pronave, në këtë periudhë është edhe marrja e pronës në përdorim, ku pasuria e paluajtshme dhe e luajtshme e personave të veçantë, e kooperativave bujqësore dhe e organizatave të tjera shoqërore, kur e kërkonte interesi i përgjithshëm, mund të merreshin në përdorim të përkohshëm për nevoja të ngutshme shtetërore për një afat deri në tre vjet, ku me vendim të Komitetit të Rrethit ku gjendej prona bëhej marrja e pronës në përdorim, caktimi i afatit të përdorimit, masa e pagesës dhe enti i cili duhej të bënte pagesën. Në llogaritjen e masës së shpronësimit, pavarësisht nga shpërblimi që do të jepej, kjo llogaritje bëhej mbi bazën e një rregulli të mirë caktuar duke plotësuar: Preventivin e vlerës fillestare të objektit sipas çmimeve në fuqi në kohën shpronësimit; Përcaktimin e moshës së godinës; Përcaktimin e shkallës së amortizimit të objektit që shpronësohet; Për raste të veçanta, kur nuk mund të siguroheshin të dhënat e mësipërme, gjendja reale e ndërtesës dhe shkalla e amortizimit të saj, përcaktoheshin nga një komision i posaçëm. Gjatë kësaj periudhe, dhënia me qira e pronave ka qenë institucionalisht e rregulluar, ku për efekt të llogaritjes së qerasë, banesat ndaheshin në grupe dhe për secilin grup, llogaritej qiraja me bazë mujore. Si njësi bazë në qiradhënien e ndërtesave në qytet dhe në fshat ka qenë qiraja mujore, në vlerë, për metër katror sipërfaqe ndërtimi. Kur objekti ishte shumëkatësh, llogaritja e sipërfaqes së ndërtimit bëhej për çdo kat dhe kjo njësi merrej si vlere bazë e qerasë, mbi të cilën, për disa rrethana të veçanta, mbi këtë vlerë, aplikoheshin

shtesa, ose pakësimi. Bëhej fjalë për rrethana të tilla si: gjendja fizike e pronës, largësia nga qendra e banuar, sipërfaqja e oborrit, e të tjerë elementë të cilët edhe sipas standardeve evropiane të vlerësimit, kanë gjetur zbatim të gjerë në metodën e krahasimit të vlerësimit të pasurisë. Me ndryshimet demokratike të viteve '90, të cilat kulmojnë me ndryshimet e sistemit shoqëror në Shqipëri, përmes Dispozitave Kryesore Kushtetuese të vitit 1991, trajtimin të pronave iu dha një frymëmarrje e plotë, tashmë ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, në iniciativën e lirë të të gjithë subjekteve ekonomike dhe në rolin rregullues të shtetit. Mbi bazën e këtyre dispozitave, subjekte të së drejtës së pronës janë: shteti, personat juridikë, personat fizikë, etj, nga ana tjetër të gjitha llojet e pronave gëzojnë mbrojtje të barabartë para ligjit.

Me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të vitit 1998, prona merr udhën e trajtimin të saj sipas standardeve më të mira evropiane. Tashmë, me Kushtetute sanksionohen sa vijon: Sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në pronën private dhe në pronën publike, në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Prona private dhe publike mbrohen njëllëj para ligjit. E drejta e pronës private është e garantuar. Prona fitohet me dhurim, trashëgim, blerje si edhe me mënyra të tjera të parashikuara në Kodin Civil. Ndryshimet epokale të ndodhura në Shqipërinë e viteve '90, do të reflektoheshin edhe në trajtimin e pronës, ku tashmë në mënyrë të konsiderueshme filloi shitë/blerja, dhënia me qira dhe nën qira e pronës, privatizimi i aseteve shtetërore, ardhja e investimeve dhe investitorëve të huaj në Shqipëri, zhvillime të cilat kërkonin që edhe vlerësimi i pronës tashme të trajtohej sipas standardeve evropiane. Por, për të bërë një gjë të tillë nevojitej formimi profesional i vlerësuesve të pasurisë së paluajtshme, një profesion i panjohur në Shqipërinë e para viteve '90. Kështu përgjatë viteve 1993 -1996, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakulteti Ekonomik, në bashkëpunim me Z. David A. Allen, nga Anglia, (i cili, që nga viti 2013 mban titullin "Anëtar Nderi" i Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurisë së Paluajtshme të Shqipërisë), u hap kursi pasuniversitar një vjeçar mbi pasuritë e paluajtshme, duke krijuar specialistët e parë vlerësues në këtë fushë. Nga ana tjetër, në vitin 1995, për herë të parë, në Shqipëri krijohet Shoqata e Vlerësuesve të Pasurisë së Paluajtshme, shoqatë e cila, nga kjo periudhë organizoi hapjen e kurseve profesionale për vlerësimin e pasurive duke u mbështetur në programe sipas metodave bashkëkohore të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme. Në rrethanat e krijuara, në vitin 1996, me Vendim të Këshillit të Ministrave, për herë të parë në Shqipëri pranë Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit krijohet Komisioni i Posaçëm për dhënien e licencave për vlerësimin e pasurive të

(Vijon në faqen 11)

LIBRI

Një ndër veprat më të arrira të publicistit, poetit e shkrimtarit, tashmë të mirënjohur Sakip Cami

“LANÇ në Dibër”, vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare

Halil Rama

“LANÇ në Dibër” është padyshim ndër veprat më të arrira të publicistit, poetit e shkrimtarit, tashmë të mirënjohur Sakip Cami, duke mbushur kështu vaakumin e krijuar për një nga periudhat më të lavdishme të historisë së Shqipërisë.

Nëse i madhi, Prof.dr.Kristo Frashëri na la si trashëgimi veprën shumëdimensionale “Historia e Dibrës” nga lashtësia deri më 1939 (të cilën, ndoshta nga pamundësia moshore, apo nga ndikime të jashtme njerëzore, nuk arriti ta çojë më tej në periudhat e mëpasme historike), ashtu si dhe historiani ynë i shquar Moisi Murra, historinë e pesë viteve të okupimit nazifashist dhe të luftës së paepur kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij merr përsipër ta ndriçojë me fakte dhe argumente Sakip Cami.

Kur nisi punën për këtë vepër, duke e patur mik e bashkëpunëtor të ngushtë prej më shumë se tri dekada, miqësisht i thashë: “Kam besim të plotë në punën tuaj studimore, por shmangiu sa më shumë interpretimeve!”.

Por kur e përfundoi së shkruari dhe ma dha për redaktim, konstatova me kënaqësi kontributin e vyer të z.Cami për një vepër tejet dinjitoze.

“LANÇ në Dibër” është libri që hedh dritë për ngjarje e fakte të mbetura disi në errësirë, ose të shtrembëruara qëllimisht e të pasyqruara si të tilla nga his-



toriografia e viteve të para ‘90-tës.

Në katër kapitujt e librit jepen detaje dhe fakte të panjohura për veçoritë e LANÇ në Dibër dhe në Dibër të Madhe, për formacionet luftarake dhe luftimet e zhvilluara, për heronjtë dhe dëshmorët sidhe lista e dëshmorëve të Dibrës sipas Arkivit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në tërësinë e fakteve dhe humbjeve të panumërta në njerëz dhe në materiale të një Evrope që u shkatërrua tërësisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, S.Cami evidenton ato që ndodhën në Dibër. Përmes faktesh të pamohuara, duke u ndalur veçmas në përcaktimin e kufijve kohorë të kësaj Luftë (Kufirin

kohor e përcaktojnë ardhja dhe largimi i pushtuesve që është 7 prilli i vitit 1939 dhe ikja e tyre më 28 nëntor 1944) autori i kësaj vepre rendit ngjarjet në mënyrë kronologjike.

Brenda këtij kufiri kohor evidenton ngjarje dhe fakte, ku padyshim përveç tiparit çlirimtar të kësaj lufte që është determinant, nënvizon edhe tiparet e një lufte që u bë për pushtet, (që kurresesi nuk mund të konsiderohet luftë civile) por pa e zbehur kështu tiparin e saj kryesor, atë çlirimtar e liridashës.

Mjaftojnë këto fakte për t’u bindur në konkluzionin se edhe në Dibër periudha e Luftës së II-të Botërore rezultoi si periudha e konfliktit ushtarak më të përgjithshëm e më të përgjakshëm në historinë e njerëzimit, për të shuar sa më shumë jetë njerëzish si dhe për të shkatërruar sa më tepër vlera materiale, kulturore, etnografike, historike, e të tjera, të krijuara nga brezat njerëzorë ndër shekuj.

Sakip Cami këtë e bën më së miri nëpërmjet historisë së çetave luftarake (Të Dibrës e të Gollobordës), duke u ndalur veçmas tek Lufta kundër fashistëve italianë në Dibër; Lufta kundër nazistëve gjermanë në Dibër si dhe tek Lufta e njësive të mëdha partizane.

Analizën e veprës e ka bërë në mënyrë të hollësishme prof.dr.Bernard Zotaj në parathënien e saj, por unë dua të përçoj tek lexuesi mesazhin e domosdoshmërisë së pasurimit të bibliotekës së tij me këtë libër që zë vend të veçantë në fondin e historiografisë sonë të viteve 40-të të shekullit të kaluar. Kjo edhe për faktin se nga mënyra dhe stili i veçantë i të shkruarit, faktet dhe analizat që sjell, “LANÇ në Dibër” është një vepër që pasuron dukshëm fondin e letërsisë sonë dokumentare.

HISTORIA E TRAJTIMIT TË PRONËS NË SHQIPËRI

(Vijon nga faqja 10)

paluajtshme, duke institucionalizuar në këtë mënyrë për herë të parë krijimin e profesionit të ekspertit vlerësues për llogaritjen e vlerës së tregut të lirë të pronës sipas parimeve dhe standardeve evropiane të tregut të lirë, ky vendim konsideron të pavlefshëm çdo ushtrim profesioni ose licencë të këtij karakteri që bie ndesh me të. Nga viti 1996 Shoqëria e Vlerësuesve të pasurive të paluajtshme të Shqipërisë bëhet anëtare e Grupimit Evropian të Vlerësuesve të Pasurive, “TEGOVA” (The European Group of Valuears Associations), e cila është Korporata e vendosjes së standardeve të vlerësimit të pronave brenda Komunitetit Evropian, standarde të cilat përputhen me ato të vendosura nga Komuniteti Ndërkombëtar i Standardeve të Vlerësimit të pasurive të paluajtshme (TIAVSC). Nga viti 1996 deri në vitin 2005, kurset e formimit të vlerësuesve të pasurive të paluajtshme organizoheshin nga shoqata e vlerësuesve të pasurisë së paluajtshme, programi i së cilës në vitin 2005 u konsiderua si i paplotë dhe të gjithë ata që ishin certifikuar në këtë periudhë dhe nuk kishin marrë licencën e shkallës së parë dhe dëshironin të ushtronin këtë profesion, duhej të bënin ekuivalentimin sipas programit

të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të cilit i kaloi e drejta e organizimit të këtij kursi në fushën tokë truall dhe ndërtesë. Nga viti 2016, formimi profesional në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme të tokës bujqësore, tokë pyjore, tokë kullotë, tokë livadhe dhe tokë të pafrytshme bëhet në formën e kursit pasuniversitare pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Nga viti 2017, formimi profesional në fushën e pasurive të linjave tekonolligjike dhe makinerive dhe paisjeve bëhet pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike. Aktualisht, dhënia e licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe linjave tekonolligjike, makinerive dhe paisjeve bëhet nga Komisioni i Posaçëm Qeveritar i ngritur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Dhënia e licencave bëhet me dy nivele, që janë: licencë e shkallës së parë dhe licencë e shkallës së dytë. Shkalla e parë e licensimit si për individ, ashtu dhe për shoqëritë ka të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të vlerësimit pa asnjë kufizim në pikat e miratuara. Me Shkallën e dytë të licensimit, individit ka të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të vlerësimit pranë një shoqërie ose një individit që është vlerësues i shkallës së parë. Licenca e shkallës së dytë fitohet me plotësimin e kriter-

eve specifike, ndërsa licenca e shkallës së parë, veç kriterëve specifike nevojitet të ketë dhe një eksperience jo me pak se dy vjet punë pranë një vlerësuesi të shkallës së parë ose shoqërie, ndërsa shoqëritë me përmbushjen e kriterëve përfitojnë vetëm licencë të shkallës së parë. Secila nga shkallët e licensimit klasifikohet të ushtrojë veprimtarinë në fushat e pronave të cilat janë: Subjekte vlerësues për “tokë truall dhe ndërtesë”. Subjekte vlerësues për “tokë bujqësore, tokë pyjore, tokë kullotë, tokë livadhe dhe tokë të pafrytshme”. Subjekte vlerësues për “linjave tekonolligjike dhe makinerive dhe paisjeve”.

Subjekti vlerësues me përmbushjen e kriterëve mund të përfitojë licencë dhe të ushtrojë veprimtari në secilën nga fushat e mësipërme. Procesi i vlerësimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri, në tërësinë e tij është një proces relativisht i ri në të gjithë komponentët e tij, i cili po ecën me ritme të shpejta në përmirësimin dhe përsosjen me qëllimin përfundimtar të përputhjes së plotë të tij me Standardet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Në përgatitjen e këtij shkrimi u bazuam në veprën: “Bazat e Matjeve në vlerësimin e pasurive të paluajtshme (BM-VPP)” Tiranë 2016, me të njëjtin autor.

SPECIALE

KUVENDI I VAZHDIMËSISË SË OBVL-së

Fotoreportazh nga Xhelal MARKU



Gjen.Brigade Manushaqe Shehu, zv. shef i Shtabit të Përgjishëm vlerëson kontributin e OBVL



OBVL nderon me Çertifikata Mirënjohje disa personalitete



Zv.Ministri i Mbrojtjes
Petro Koçi vlerëson
kontributin e OBVL në
mbrojtje të vlerave të
LANÇ



Sekretari i Përgj. av.Halil Rama hap Kuvendin e 7 te OBVL



Flet në Kuvend kryetari i Degës së OBVL Shkodër,
kol.Ali Demushi



Kryetari i OBVL kol.ing.Myfit Guxholli mban
Raportin në Kuvendin e VII-të



Nenkryetari i OBVL Maksim Vinçani publikon
Rezolutën e Kuvendit



Natasha dhe Dashamir Tahiri, dy pasardhës të denjë të ish
kryetarit të degës së OBVL Përmet, i paharruari Syrja Tahiri



Flet në Kuvend nënkryetari i OBVL, Prof.dr.Shefqet Hoxha

